



UNHCR
The UN Refugee Agency



TLAS



HARTËZIMI I POPULLSISË NË RREZIK PASHTETËSIE NË SHQIPËRI

Mirënjohje

Ky raport u shkrua nga një grup ekspertësh të Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS) me mbështetjen e UNHCR në Shqipëri. Raporti u draftua nga Maylis de Verneuil, eksperte TLAS, Lorena Isla Rodriguez, UNHCR dhe u redaktua nga David Whitbourn, ekspert i TLAS. Metodologjia dhe mjetet e hulumtimit u hartuan nga Raimonda Bozo, Anisa Metalla, TLAS. Për redaktimin e raportit kontribuan gjithashtu Anisa Metalla, Raimonda Bozo, Herald Kosta, në emër të TLAS dhe Fatmir Mema nga Universiteti i Tiranës, Erjona Dharmo nga INSTAT. Raporti u korrektua nga Herald Kosta dhe Borana Resulaj, TLAS.

Falenderime të veçanta janë të nevojshme për një grup të madh kërkuesish, më së shumti nga strukturat shtetërore dhe OshC-të partnere. Në mënyrë specifike, TLAS do donte të përmendte Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, Drejtorinë e Arsimit Parauniversitar, Drejtorinë e Shëndetit Publik, Drejtorinë e Shërbimeve Sociale dhe Strukturat për Mbrojtjen e Femijës për dedikimin e tyre.

Ky studim nuk do mund të realizohej pa ndihmën e personave që rrezikojnë pashtetësinë dhe ranë dakord të ndanin eksperiencat e tyre jetësore me intervistuesit e TLAS. I jemi mirënjohës drejtuesve të institucioneve dhe personave që pranuan të intervistohen për të ndarë eksperiencat e tyre dhe dhanë pëlqimin që çështjet e tyre të analizohen për qëllimet e këtij raporti.

Kryerja e këtij hartëzimi ka qenë një përpjekje e përbashkët me ministri të ndryshme të qeverisë shqiptare, duke përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile brenda Ministrisë së Brendshme, Drejtorinë e Çështjeve Konsullore brenda Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Sociale dhe Drejtorinë e Shëndetit Publik në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorinë e Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit, Drejtorinë e Statistikave Sociale në INSTAT, si dhe me organizata ndërkombëtare dhe jo-qeveritare, duke përfshirë UNDP dhe UNICEF.

NA KONTAKTONI

UNHCR

Adresa:
Rruga "Skënderbej", ndërtesa Gurten,
Kati 2-të, Tiranë, Shqipëri

Kontakte

Tel/Fax: +355 4 22 502 84

E-mail: albti@unhcr.org
Web: www.unhcr.org

FOTO E KOPERTINËS:

Foto nga Armando Bode

Tirana Legal Aid Society

Adresa:
Pallatet Agimi, Shkalla 18 /322
P.O BOX 69, Tiranë, Shqipëri

Kontakte

Tel/Mob: 04 2258442 +355 69 20 93731

Email: tlas@tlas.org.al
Web: www.tlas.org.al
www.portal.tlas.org.al

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
- Gjetjet kryesore	6
- Rekomandimet kryesore	7
1. HYRJE	10
1.1. Qëllimi i raportit: Pse nevojitet hartëzimi i personave në rrezik pashtetësie në Shqipëri?	10
1.2.1. Shënime paraprake për përgatitjen e raportit	11
1.2.1.1. Kontribuesit	11
1.2.1.2. Semantika e përdorur në këtë raport	12
1.2.2. Metodologjia e përdorur në këtë raport	13
1.3.1. Metodologjia kuantitative	15
1.3.2. Metodologjia kualitative	16
2. PASHTETËSIA NË BOTË	17
2.1. Përmbledhje e situatës së pashtetësisë në botë	17
2.2. Përkufizime	18
2.3. Shkaqet e pashtetësisë	18
2.4. Pasojat e pashtetësisë	21
3. KUADRI LIGJOR NDËRKOMBËTAR DHE RAJONAL	23
3.1 Ligji Ndërkombëtar mbi Pashtetësinë	23
3.1.1. Konventa të veçanta për pashtetësinë	23
3.1.2. Instrumente të tjera ligjore për pashtetësinë në ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut	24
3.2 Pashtetësia në Ligjin Rajonal	25
3.3. Roli dhe mandati i UNHCR për pashtetësinë	25
4. ANALIZA E KORNIZËS LIGJORE NË LIDHJE ME PASHTETËSINË NË SHQIPËRI	29
4.1. Përmbledhje e kuadrit ligjor të Shqipërisë dhe detyrimet ndërkombëtare	29
4.1.1. Detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë	29
4.1.2. Hierarkia e normave ligjore në Shqipëri	30
4.2. Regjimi ekzistues mbi shtetësinë në Shqipëri	31
4.2.1. Një kombinim i principeve jus soli dhe jus sanguinis	31
4.2.2. Marrja e shtetësisë me anë të natyralizimit	32
4.2.3. Humbja e shtetësisë	33
4.3. Pashtetësia në ligjin shqiptar	33
4.3.1. Një përcaktim i paplotë i shtetësisë	33
4.3.2. Parandalimi i pashtetësisë	34
4.3.2.1. Parandalimi i pashtetësisë në lindje	34
4.3.2.1.1. Dhënia e shtetësisë fëmijëve pa shtetësi të lindur në territorin shqiptar	34
4.3.2.1.2. Dhënia e shtetësisë fëmijëve pa shtetësi lindur jashtë vendit	35

4.3.2.2. Parandalimi i pashtetësisë në kontekste të tjera	36
4.3.2.2.1. Fëmijët e braktisur	36
4.3.2.2.2. Birësimi dhe Surrogacia	37
4.3.2.2.3. Rifitimi i shtetësisë shqiptare	38
4.3.3. Regjistrimi i lindjes dhe atësia	38
4.3.4. Regjistrimi i lindjes dhe pashtetësia	39
5. KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE TË PERSONAVE NË RREZIK PASHTETËSIE NË SHQIPËRI	42
5.1 Vështirësitë e hartëzimit të personave në rrezik pashtetësie në Shqipëri	42
5.2. Një përmbledhje statistikore për popullatën e njerëzve në rrezik pashtetësie në Shqipëri	42
5.2.1 Shpërndarja gjeografike e personave në rrezik pashtetësie	46
5.2.2 Shkaqet kryesore — mungesa e dokumentacionit civil/ regjistrimit të lindjes	48
5.2.3 Shpërndarja e personave në rrezik pashtetësie sipas vendlindjes	49
5.3 Burimet e të dhënave	50
5.3.1. Grupet e mbuluara nga të dhënat administrative dhe jo-administrative	50
5.3.1.1 Identifikimi i rasteve me anë të projektit “Sokrates”	51
6. SFIDAT E NGELURA PËR PARANDALIMIN E PASHTETËSISË DHE MBROJTJEN E PERSONAVE NË RREZIK PASHTETËSIE NË SHQIPËRI	52
6.1. Parandalimi i pashtetësisë	52
6.1.1. Mangësitë e legjislacionit shqiptar	52
6.1.1.1. Mungesa e procedurave të përcaktimit të pashtetësisë	52
6.1.1.2. Mungesa e procedurave jo të kontestueshme për të rregulluar regjistrimin e parakohshëm të lindjes	53
6.1.2. Regjistrimi i lindjeve dhe sfidat burokratike	54
6.1.2.1. Në Shqipëri	54
6.1.2.2. Jashtë vendit	55
6.1.3. Regjistrimi pasues	56
6.2. Mbrojtjet në dispozicion për personat pa shtetësi dhe personat në rrezik të pashtetësisë	57
6.2.1. Pengesat për akses në drejtësi dhe ndihmë juridike	57
6.2.2. Faktori i diskriminimit	59
7. KONKLuzionET	60
7.1. Konkluzionet	60
SHTOJCAT	62
SHTOJCA 1	62
SHTOJCA 2	65
SHTOJCA 3	71
BIBLIOGRAFIA & REFERENCAT	75

Lista e shkurtesave

AShMDF (SAPCR)	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve	KSPP (CSSP)	Konventa për Statusin e Personave Pa Shtetësi (1954)
BE (EU)	Bashkimi European	MASR (MoESY)	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
DUDNj (UDHR)	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948)	MB (MoI)	Ministria e Brendshme
FAK (CWD)	Fëmijë me Aftësi të Kufizuara	MD (MoJ)	Ministria e Drejtësisë
GjEDNj (EctHR)	Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut	MEPJ (MoEFAA)	Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave	MShMS (MoHSW)	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
IPGj (ISI)	Instituti mbi Pashtetësinë dhe Gjithëpërfshirjen	NjMF (CPU)	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës
KDF (CRC)	Konventa për të Drejtat e Fëmijës (1989)	OJQ (NGO)	Organizatë Jo Qeveritare
KDNj (HRC)	Komiteti i të Drejtave të Njeriut	OKB (UN)	Organizata e Kombeve të Bashkuara
KDPAK (CRPD)	Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (2006)	ONE (IOM)	Organizata Ndërkombëtare e Emigrimit
KE (CoE)	Këshilli i Europës	OShC (CSO)	Organizatë e Shoqërisë Civile
KEDNG (CEDAW)	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave (1979)	PNDCP (ICCPR)	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (1966)
KEDNj (ECHR)	Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (1950)	PNDESK (ICESCR)	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966)
KEDR (CERD)	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (1965)	RrEE (EMN)	Rrjeti European i Emigrimit
KEDS (ECSR)	Komiteti European për të Drejtat Sociale	RrEP (ENS)	Rrjeti European i Pashtetësisë
KESh (ECN)	Konventa Europiane për Shtetësinë (1997)	STKB (UNTS)	Seria e Traktateve të Kombeve të Bashkuara
KNL (ILC)	Komiteti Ndërkombëtar i Ligjit	ShSSh (SSS)	Shërbimi Social Shtetëror
KomEk (ExCom)	Komiteti Ekzekutiv i Programit të Komisionerit të Lartë të Refugjatëve të Kombeve të Bashkuara	TLAS	Shërbimi Ligjor Falas Tiranë
KRP (CRS)	Konventa për Reduktimin e Pashtetësisë (1961)	UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
KSE (ESC)	Karta Sociale Europiane (1961)	UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
KSEKB (ECOSOC)	Këshilli Social dhe Ekonomik i Kombeve të Bashkuara	UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
		VDBE (EUDO)	Vëzhguesi i Demokracisë në Bashkimin European

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- Gjetjet kryesore

Ky raport zbuloi 1031 njerëz të cilëve nuk i njihet nga shteti ekzistenca e tyre si shtetas shqiptar. Numri total mund të jetë disa herë më i madh duke qenë se pashtetësia është një problem i fshehur, i vështirë për t'u matur nga çensuset apo anketat.

Objektivat e këtij raporti janë zhvillimi i një analize të thelluar mbi faktorët që ndikojnë në rrezikun e pashtetësisë në Shqipëri dhe ofrimi i një pikturë të qartë të karakteristikave demografike të personave në rrezik. Ky studim tregon se shumica e individëve që ndeshin këtë rrezik kanë të drejtën të përfitojnë shtetësinë, bazuar në ligjin mbi shtetësinë, por gjejnë vështirësi për ta konfirmuar në praktikë.

Pengesa kryesore mbetet aksesimi në regjistrimin e lindjes, e cila është problematike për shkak të procedurave administrative dhe gjyqësore të gjata dhe të kushtueshme. Ky problem dëmton veçanërisht komunitetet Rom dhe Egjiptian, të cilët ndodhen shpesh në situata marginalizimi social dhe ekonomik, por edhe emigrantët që rikthehen në Shqipëri, të cilët kanë lindur fëmijë jashtë vendit. 97% e individëve të regjistruar si pa shtetësi në Shqipëri janë fëmijë. Pak më pak se 50% e këtyre fëmijëve janë nën 5 vjeç.

Shkaqet primare të pashtetësisë janë të lindurit jashtë Shqipërisë (53%), të lindurit jashtë martese (12%), të lindurit në shtëpi (10%) dhe të lindurit në spital ose në maternitet por me të dhëna personale të nënës të pasakta (9%). Së bashku, 84% e rasteve të pashtetësisë të identifikuar janë të lidhura me procedura të regjistrimit të lindjes. Nga individët në fjalë të lindur jashtë Shqipërisë, shumica vijnë nga Greqia (53%), ndjekur nga Gjermania (29%), Kosova (6%) dhe 12% i mbetur nga vende të tjera.

Anëtarët e komuniteteve Rom dhe Egjiptian ndikohen në mënyrë disproporcionale nga ky problem. Individët romë dhe egjiptianë pa shtetësi përbëjnë gjysmën e rasteve të identifikuar pavarësisht se si komunitete përbëjnë vetëm ndërmjet 0.4% dhe 3.3% të popullsisë në territorin e Republikës së Shqipërisë (në varësi të matjes).¹

Gjeografikisht, në terma absolutë, Tirana është vendi me më shumë persona pa shtetësi (18% e atyre të identifikuar), ndjekur nga Fieri (12%), Shkodra (11%) dhe Gjirokastra (10%). Sidoqoftë, nëse merret përhapja relative e pashtetësisë (duke marrë parasysh popullsinë totale të qarkut), Gjirokastra dhe Be-

¹ INSTAT/UNDP, Roma and Egyptians in Albania: a socio-demographic and economic profile based on the 2011 census [Roma dhe egjiptianët në Shqipëri : Një profilizim socio-demografik bazuar në censusin e 2011], Prill 2015.

rati janë qarqet me problemin më të madh lidhur me këtë çështje.

Republika e Shqipërisë aderon që nga viti 2003 në të dyja Konventat e Kombeve të Bashkuara, për Statusin e Personave Pa Shtetësi (1954) dhe për Reduktimin e Pashtetësisë (1961). Ligji për të Huajt përfshin një përkufizim të personit pa shtetësi dhe parashikon lëshimin e një leje banimi për këta individë për arsye humanitare. Sidoqoftë, për shkak të mungesës së një procedure të duhur për përcaktimin e pashtetësisë, dispozita për lëshimin e lejes së banimit nuk përdoret në praktikë.

- Rekomandimet kryesore

Çdo metodë për zgjidhjen e problemit të pashtetësisë në Shqipëri do të kërkojë domosdoshmërisht një partneritet midis shtetit, organizatave ndërkombëtare, organizatave jo-qeveritare (OJQ) dhe komunitetit.

Regjistrimi civil dhe ai i lindjeve duhet të thjeshtohen dhe stafi përkatës të stërvitet për t'i ekzekutuar këto procedura në mënyrë efçente, pa diskriminuar askënd. Të gjitha kërkesat jo të domosdoshme përse i përket dokumentacionit duhet të thjeshtohen dhe kostot e aplikantit duhet të ulen sa më shumë të jetë e mundur. Duhet të prezantohet një sistem efçent dhe i kompjuterizuar i regjistrimit të lindjeve, i shpërndarë në të gjitha institucionet e përfshira.

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, mund të bëjmë rekomandimet e mëposhtme:

Detyrimet ndërkombëtare dhe rajonale

Qeveria shqiptare duhet të sigurojë që të gjitha detyrimet ndërkombëtare dhe rajonale në lidhje me të drejtën e shtetësisë, parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë, mbrojtjen e personave pa shtetësi, mosdiskriminimin dhe regjistrimin e lindjeve të jenë plotësisht të përfshira në ligjin vendas dhe të zbatohen në praktikë. Tri pjesët thelbësore të legjisllacionit në këtë drejtim janë Ligji për Shtetësinë, Ligji për Gjendjen Civile dhe Kodi i Familjes.

Regjistrimi i lindjes

Qeveria shqiptare duhet të ndërmarrë hapa për të reformuar ligjin dhe praktikën që pengon marrjen e shtetësisë shqiptare dhe të ruajë të drejtën e çdo fëmije për një shtetësi, pavarësisht nga statusi, dokumentacioni ose veprimet e prindërve të tyre. Kjo do të thotë të sigurojë identitetin ligjor për të gjithë, duke përfshirë garantimin e regjistrimit universal, të lirë dhe të menjëhershëm të lindjes për çdo fëmijë, pavarësisht nga statusi i prindërve, dokumentacioni, ose nëse fëmija ka lindur në një institucion mjekësor.

Procedurat e regjistrimit civil

Qeveria shqiptare duhet të sigurojë që të gjitha procedurat e regjistrimit civil dhe të dokumentimit, duke përfshirë regjistrimin e lindjeve, të jenë të aksesueshme nga të gjithë duke thjeshtuar procedurat komplekse dhe duke eliminuar pengesat që lidhen me koston, kohën, distancën dhe burokracinë.

Bashkëpunim ndërministror

Bashkëpunimi midis Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës është një element thelbësor për adresimin e problemeve burokratike të lidhura me njohjen e shtetësisë shqiptare për fëmijët e shtetasve shqiptarë të lindur jashtë. Për më tepër Ministria e Punëve të Brendshme duhet të punojë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Arsimit për të përmirësuar identifikimin e atyre në rrezik pashtetësie në nivel vendor dhe kombëtar.

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe shërbimet e konsullatës

Qeveria shqiptare duhet të forcojë bashkëpunimin me shtetet e tjera, dhe në veçanti me Greqinë, për çështjen e regjistrimit të lindjeve për shtetasit shqiptarë, fëmijët e të cilëve janë të lindur jashtë vendit. Nevojiten procedura të thjeshtuara për korrigjimin e të dhënave dhe unifikimin e akteve dhe çertifikatave të lindjes.

Trajtimi i paragjykitimit dhe diskriminimit

Qeveria shqiptare duhet të veprojë për të trajtuar diskriminimin strukturor ndaj komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, duke përfshirë qendrimet paragjykuese dhe stereotipet negative, për të siguruar që këto komunitete të mos diskriminohen direkt ose indirekt në aksesin e tyre në dokumentacion, gëzimin e të drejtës së tyre për një shtetësi dhe të të drejtave të tjera të njeriut.

Aksesi në drejtësi

Qeveria shqiptare duhet të sigurojë mjete efektive për të gjithë ata që kërkojnë të zgjidhin statusin e tyre të dokumentacionit, duke përfshirë ndihmën juridike me cilësi të lartë, të financuar nga shteti (përfitimi i të cilës nuk duhet të kushtëzohet me kriterin e parqitjes së dokumentacionit që këtyre personave Ju mungon) heqjen e pengesave si tarifatat gjyqësore ose tarifatat për testin e ADN-së, mbikëqyrjen gjyqësore, dhe mekanizma eficientë ankimi dhe kompensimi.

Procedura e përcaktimit të pashtetësisë

Në veçanti, Shqipëria duhet të paraqesë një procedurë në ligj për të identifikuar dhe mbrojtur personat pa shtetësi në përputhje me Konventën e vitit 1954 dhe Udhëzimet e UNHCR.

Për më tepër, sapo të ekzistojë një procedurë e përcaktimit të pashtetësisë, personave të njohur si pa shtetësi do t'u garantohet një akses real dhe efektiv për të drejtat dhe shërbimet. Për ata që kanë të drejtë të gëzojnë shtetësinë shqiptare, miratimi i shtetësisë duhet të ngelet alternativa optimale.

Bashkëpunim më i ngushtë ndërmjet institucioneve publike dhe OShC

Qeveria e Shqipërisë dhe organizatat e shoqërisë civile të angazhuara për parandalimin e pashtetësisë duhet të forcojnë bashkëpunimin midis tyre dhe të punojnë së bashku për nxitjen e zgjidhjeve të qëndrueshme.

Trajnimi i personelit dhe ngritja e kapaciteteve

Qeveria shqiptare duhet të mandatojë një zhvillim profesional rigoroz dhe të vazhdueshëm për të gjithë zyrtarët shtetërorë, siç janë stafi i gjendjes civile, punonjësit e shëndetësisë dhe zyrtarët konsullorë, të cilët luajnë një rol ligjor në procedurat e regjistrimit civil. Duke punuar me ekspertë të rëndësishëm, qeveria duhet të sigurojë që këta zyrtarë, vendimmarrës dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm të jenë të pajisur për të trajtuar pashtetësinë dhe diskriminimin, duke ofruar trajnime dhe ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve në tema kryesore duke përfshirë barazinë dhe mosdiskriminimin, pashtetësinë dhe të drejtën publike.

1. HYRJE

1.1. Qëllimi i raportit: Pse nevojitet hartëzimi i personave në rrezik pashtetësie në Shqipëri?

UNHCR ka ndërmarrë një plan aksioni global për të zgjidhur përfundimisht problemin e pashtetësisë. Ky plan u hartua duke u konsultuar me shtetet, shoqërinë civile dhe organizata ndërkombëtare dhe synon të zhbëjë problemin deri në 2024. Për të sjellë këtë rezultat, përhapja, vendndodhja dhe shkaqet e problemit duhet të kuptohen mirë. Në këtë drejtim, Aksioni 10, "Përmirësimi i të dhënave kualitative dhe kuantitative për personat pa shtetësi" nxit hartëzimin e pashtetësisë. "Statistika dhe të dhëna mbi situatën e personave pa shtetësi mund të mblidhen duke përdorur një gamë të gjerë metodash, duke përfshirë analizat e të dhënave të regjistrimit civil, çensuset e popullsisë dhe anketat e studimet specifike."²

Objekti është hartimi i një analize kualitative për rrezikun e pashtetësisë, bazuar në të dhënat ekzistuese mbi personat pa shtetësi të mbledhura nga institucionet publike dhe aktorët e shoqërisë civile, dhe i rekomandimeve konkrete, praktike dhe efektive për shtetin në fjalë.

Në Europë, ndarja e shteteve pas komunizmit është një shkak që ka sjellë probleme të rëndësishme pashtetësie. Nga 1991, ndarja e ish-Republikës Socialiste të Jugosllavisë dhe konfliktet që e ndoqën lanë dhjetëra mijëra në rrezik pashtetësie. Ky problem u bë dhe më i rëndë nga shkatërrimi i dokumentacionit përkatës. Në fakt, përgjatë rajonit, nuk ekziston një numër i saktë i personave pa shtetësi dhe për këtë arsye hartëzimi i pashtetësisë është ndërmarrë në sejcilin vend të Europës juglindore.

Në tetor 2011, zyrtarë nga Bosnia dhe Herzegovina, Kroacia, ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova³, Mali i Zi dhe Serbia u mblodhën në një Konferencë Rajonale për Ofrimin e Dokumentacionit dhe Regjistrimit Civil në Europën Juglindore. Ata miratuan Deklaratën e Zagrebit, ku ranë dakord, ndër-mjet të tjerave, për të hequr të gjitha pengesat përpara i përket dokumentacionit dhe regjistrimit civil, duke pasur në mendje sidomos njerëzit vulnerabël. Kjo përfshin reforma ligjore, regjistrimin e vendbanimit dhe të tilla kërkesa për dokumente që janë të mundshme edhe për refugjatët, heqjen e tarifave, thjeshtim të regjistrimit të lindjeve dhe lëshimin e kartave të identitetit⁴.

² Cf. <http://www.unhcr.org/protection/statelessness/54621bf49/global-action-plan-end-statelessness-2014-2024.html>

³ Ky përcaktim nuk përmban ndonjë paragjykim për statusin e Kosovës dhe është në linjë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244/1999 dhe me Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë përpara i përket deklarimit të pavarësisë së Kosovës.

⁴ Deklarate e Zagrebit, 27 tetor 2011,

<http://www.unhcr.org/events/commemorations/4ec12d0d9/zagreb-declaration-conference-provision-civil-status-documentation-registration.html>

Sipas të dhënave më të fundit të mbledhura në censusin e 2011 nga Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT), në Shqipëri ka 7443 persona të peregjistruar⁵. Nga ky total, 3847 u identifikuan si meshkuj dhe 3569 si femra.

Pashtetësia mund të çojë në mohimin e të drejtave ose të bëhet një pengesë për aksesimin e të drejtave, duke qenë se individët kthehen “juridikisht të padukshëm.” Ky raport sjell një përmbledhjeve të gjetjeve nga një ushtrim i përbashkët identifikimi duke përfshirë njësitë përkatëse qeveritare, UNHCR dhe TLAS. Ky ushtrim synon të ofrojë një vlerësim realist për popullsinë në rrezik pashtetësie në Shqipëri dhe të ofrojë më shumë informacion mbi profilin e tyre, vendndodhjen gjeografike dhe shkaqet bazë. Për më tepër, ai ofron rekomandime për aksione që mund të eliminojnë pashtetësinë në Shqipëri.

Plani global i aksionit i UNHCR për të zhdukur pashtetësinë 2014-2024 ka si Aksion 1, zgjidhjen e situatave kryesore të pashtetësisë. Aksioni 6 përfshin dhënien e një statusi mbrojtje emigrantëve pa shtetësi dhe lehtësimin e natyralizimit të tyre. Aksioni 7 përfshin sigurimin e regjistrimit të lindjeve për të parandaluar situatat e reja të pashtetësisë. Në anën tjetër Aksioni 8 i referohet lëshimit të dokumenteve të shtetësisë për të gjithë që kanë të drejtë t’i marrin dhe Aksioni 10 përmirësimin të të dhënave kuantitative dhe kualitative mbi personat pa shtetësi.

Ky raport hartëzimi plotëson punë të mëparshme kërkimore të ndërmarra nga TLAS në dy studime të tjera: “T’i japim fund pashtetësisë së fëmijëve – Një Studim mbi Shqipërinë” në 2015 dhe “Pashtetësia, Diskriminimi dhe Margjinalizimi i Romëve në Shqipëri” në 2017.

Ky raport synon të profilizojë më mirë rrezikun e pashtetësisë, shkaqet dhe pasojat, segmentet e popullsisë më të cënuara dhe vendndodhjen e tyre. Me një pikturë bazë realiste të personave pa shtetësi apo në rrezik pashtetësie, UNHCR dhe TLAS mund t’i propozojnë zgjidhje qeverisë shqiptare duke zhvilluar mekanizmat e duhur për të regjistruar ata pa dokumentacion ose ata në rrezik pashtetësie.

1.2.1. Shënime paraprake për përgatitjen e raportit

1.2.1.1. Kontribuesit

Ky raport u shkrua nga një grup ekspertësh të Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS) me mbështetjen e UNHCR në Shqipëri. Raporti u draftua nga Maylis de Verneuil, eksperte TLAS, Lorena Isla Rodriguez, UNHCR dhe u redaktua nga David Whitbourn, ekspert i TLAS. Metodologjia dhe mjetet e hulumtimit u hartuan nga Raimonda Bozo, Anisa Metalla, TLAS. Për redaktimin e raportit kontribuan gjithashtu Anisa Metalla, Raimonda Bozo, Herald Kosta, në emër të TLAS dhe Fatmir Mema nga Universiteti i Tiranës,

⁵ http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/RAPORTET/RAPORTET_VJETORE/Raporti_2016.pdf

Ky numër bazohet në pyetësinë e çensusit për shtetësinë dhe në vetë-identifikimin e individëve (Formati i pyetësorit mund të gjendet në: <http://catalog.ihsn.org/index.php/catalog/4279>).

Erjona Dhamo nga INSTAT. Raporti u korrektua nga Herald Kosta dhe Borana Resulaj, TLAS.

Falenderime të veçanta janë të nevojshme për një grup të madh kërkuesish, më së shumti nga strukturat shtetërore dhe OshC-të partnere. Ne i jemi mirënjohës të gjithë individëve të intervistuar që pranuan të ndajnë eksperiencat e tyre (si funksionarëve publik ashtu dhe personave pa shtetësi). Në mënyrë specifike, TLAS do donte të përmendte Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, Drejtorinë e Arsimit Parauniversitar, Drejtorinë e Shëndetit Publik, Drejtorinë e Shërbimeve Sociale dhe Strukturat për Mbrojtjen e Femijës për dedikimin e tyre.

Gjithashtu, ky studim nuk do mund të realizohej pa ndihmën e personave që rrezikojnë pashtetësinë dhe ranë dakord të ndanin eksperiencat e tyre jetësore me intervistuesit e TLAS. Këto intervista paturuan raportin me eksperiencat personale, perceptimin e njerëzve rreth këtyre vështirësive, shpresat dhe planet e tyre. Në fakt, historitë personale ofrojnë shembuj konkretë dhe me rëndësi sesi individët në rrezik pashtetësie duhet të përballen me vështirësitë që rrjedhin prej statusit të tyre.

Kryerja e këtij hartëzimi ka qenë një përpjekje e përbashkët me ministri të ndryshme të qeverisë shqiptare, duke përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendje Civile brenda Ministrisë së Brendshme, Drejtorinë e Çështjeve Konsullore brenda Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Sociale dhe Drejtorinë e Shëndetit Publik në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorinë e Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit, Drejtorinë e Statistikave Sociale në INSTAT, si dhe me organizata ndërkombëtare dhe jo-qeveritare, duke përfshirë UNDP dhe UNHCR. Objektivi ishte aksesimi në burimet më të mira të informacionit dhe përfshirja e aktorëve që luajnë një rol kyç në parandalimin e pashtetësisë.

Së fundmi, përveç punës në terren me zyrat e gjendjes civile dhe institucione të tjera vendore dhe intervistave, çensuset dhe anketat më të fundit kanë ofruar një bazë me të dhëna statistikore për këtë projekt.

Përsa i përket dokumenteve të shkruar, vetëm një pjesë e materialeve janë përkthyer në mënyrë zyrtare në Anglisht (reporte të organizatave ndërkombëtare dhe jo-qeveritare, legjislacioni vendas dhe faqet zyrtare të internetit). Burimet e tjera (shumica e akteve administrative dhe rregulloreve) autorët kanë përdorur përkthime të kolegëve ose profesionistëve të fushës.

1.2.1.2. Semantika e përdorur në këtë raport

Për hir të qartësisë, termi “shtetësi” do të përdoret në vend të “kombësisë” në këtë raport. Në të vërtetë, termi “shtetësi” nënkupton vetëm lidhjen ligjore midis individit dhe shtetit, ndërsa “kombësia” mund t’i referohet edhe vetë-identifikimit informal të një individi me një grup gjuhësor, kulturor, fetar apo me origjinë të përbashkët.

Komuniteti Rom dhe ai Egjiptian ndeshin një nivel varfërie të vlerësuar tri herë më i lartë se ai i popullsisë tjetër shqiptare, kryesisht për shkak të një izolimi të gjatë social. Egjiptianët flasin shqip dhe njihen si më të integruar se komuniteti Rom, ndërsa këta të fundit janë njohur së fundmi zyrtarisht si një pakicë etnike⁶. Sidoqoftë, të dy këto komunitete ndeshen shpesh me të njëjtat vështirësi dhe diskriminime, ndaj në këtë raport, kur të përdorim termin “rom” do t'i referohemi dhe individëve me origjinë egjiptiane.

Shtetas dhe *shtetësi* janë termat ligjorë që përdoren në Shqipëri për të përshkruar lidhjen juridike midis shtetit dhe individit. Ato i referohen vetëm kësaj lidhje dhe të drejtave dhe detyrimeve që sjell ajo, pa ndonjë referencë për etnicitetin.

Sipar nenit 1 (paragrafi 1) të Ligjit mbi Shtetësinë Shqiptare, “Shtetësia shqiptare është një lidhje ligjore e qëndrueshme që shprehet në të drejta dhe detyrime dypalëshe midis personit fizik dhe shtetit shqiptar.” Termi *shtetas* përdoret ndonjëherë në mënyrë të njejtë si termi *qytetar*, i cili ka dhe nënkuptim politik dhe demografik. Termi *qytetar* rrjedh nga termi *qytet* dhe pavarësisht se në origjinë përdorej për të dalluar midis banuesve në qytet dhe të tjerëve, tani përdoret për të përshkruar çdo subjekt ligjor të një njësie politike (shteti).

Gjithashtu ekziston një diferencë midis termit *shtetas shqiptar* dhe *shqiptar*, ku termi i parë i referohet personave që kanë lidhje ligjore me shtetin shqiptar (pavarësisht etnisë), ndërsa termi i dytë i referohet çdo personi me etni shqiptare.

Shprehja “në rrezik pashtetësie” pasqyron një situatë ku një individ ka të drejtën e shtetësisë sipas ligjit por që ndesh pengesa për ta konfirmuar në praktikë⁷.

1.2.2. Metodologjia e përdorur në këtë raport

Metodologjia e këtij raporti u dizajnuar për të adresuar katër objektiva: a) identifikimin e të dhënave personale dhe demografike të gjithë personave në rrezik pashtetësie në vend; b) rritjen e vizibilitetit për rëndësinë e parandalimit të pashtetësisë dhe ofrimin e informacionit mbi shkaqet dhe pasojat e këtij fenomeni; c) zhvillimin e strategjive dhe zgjidhjeve për grupet e rasteve të identifikuara duke ofruar shërbime direkte ose referencë dhe asistencë për menaxhimin e rastit; d) analizimin dhe adresimin e problemeve ligjore që kërkojnë ndërhyrje të mëtejshme në legjislacion.

Struktura e metodologjisë së këtij raporti u diktua nga nevoja për një përgjigje të saktë ndaj këtyre shqetësimeve. Për të identifikuar sa më shumë raste personash në rrezik pashtetësie në Shqipëri, TLAS bashkëpunoi ngushtë me strukturat shtetërore që janë në kontakt me individët pa shtetësi, si Shërbimet Sociale, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës, Drejtoritë Rajonale të Arsimit, Drejtoritë Rajonale të

⁶ Ligji nr.96/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”

⁷ Për referencë të mëtejshme, shikoni Hugh Massey ‘UNHCR and De Facto Statelessness [UNHCR dhe Shtetësia De Facto]’, në Legal and Protection Policy Research Series, 2010: <http://www.unhcr.org/4bc2ddeb9.pdf>

Shëndetit, Zyrat e Gjendjes Civile në të gjithë territorin, OJQ-të, organizatat e shoqërisë civile (OshC) dhe organizatat me bazë komunitetin, etj.

Duke parë natyrën jo të dukshme të pashtetësisë — fenomeni përkufizohet si transformim i njerëzve në ligjërisht “të padukshëm” — një teknikë kampionimi e rastësishme nuk do të ishte e mundur për mbledhjen e të dhënave. Prandaj, duke përdorur marrëdhëniet ekzistuese me strukturat publike, TLAS dizajnoi një teknikë kampionimi të favorshme për të mbledhur sa më shumë të dhëna në një kohë të limituar. Për këtë arsye, TLAS shpërndau pyetësorë te këto struktura për të marrë informacion mbi individët e identifikuar si në rrezik pashtetësie. Anketa mbledh të dhëna që lidhen me numrin e personave në rrezik pashtetësie, emrat e tyre (ose të familjarëve), të dhënat demografike (mosha, gjinia, vendbanimi), arsyet pas mosregjistrimit dhe pasojat e mungesës së statusit (akses i limituar në shëndetësi, arsim, ndihmë ekonomike, etj.).

Përpara shpërndarjes së këtyre pyetësorëve, TLAS vlerësoi si të nevojshëm trajnimin e stafit përgjegjës për plotësimin e anketave. Fillimisht, një draft i pyetësorit u përdor si test pilot me strukturat përkatëse. Pastaj, TLAS organizoi katër mbledhje, duke përfshirë më shumë se 200 njerëz, për t'i informuar ata për rëndësinë e problemit të parandalimit të pashtetësisë, mënyrën sesi duhej plotësuar formulari dhe për të diskutuar mbi shqetësime apo këshilla që këta pjesëmarrës mund të kishin për pyetësorin pilot. Të gjithë këto shqetësime u reflektuan në formën finale të anketës. Kalendarin e këtyre mbledhjeve tregohet në tabelën më poshtë:

Data	Vendi	Institucioni	Nr. i pjesëmarrësve
24.08.2017	MShMS	Drejtorët e Drejtorive të Shëndetit Publik	35
31.08.2017	ShSSh	Shërbimet Sociale Vendore	40
22.09.2017	MASR	Drejtorët e Zyrave të Arsimit	39
29.09.2017	Hotel “Tirana”	Përfaqësuesit e Zyrave të Gjendjes Civile	87

Përfshirja e strukturave shtetërore në projektin e hartëzimit shërbeu jo vetëm për identifikimin e rasteve të rrezikut të pashtetësisë po dhe për të rritur vëmendjen e institucioneve përkatëse ndaj këtij problemi. Në këtë drejtim, shpresojmë që ky bashkëpunim të jetë vetëm hapi i parë në ngritjen e kapaciteteve publike për zgjidhjen e këtij fenomeni.

TLAS instrukttoi pjesëmarrësit për përdorimin e teknikave të kampionimit *top-bore* për të maksimizuar numrin e rasteve të identifikuara të rrezikut të pashtetësisë.

Pas mbledhjes së pyetësorëve, ekspertët e TLAS dhe UNHCR mblodhën të dhënat në databazën, ku u vlerësuan kualitativisht dhe kuantitativisht. Kjo databazë u kontrollua aritmetikisht dhe logjikisht përpara përpunimit të dhënave. Në fund, të dhënat u paraqitën në studim, kryesisht në kapitullin 5, me anë të statistikës përshkruese.

Për më shumë, TLAS zhvilloi dhe një vlerësim kualitativ të situatës me anë të intervistave me vendim-marrës kyç të fushës nga Drejtoria e Përgjithshme e Zyrës së Gjendjes Civile, Minsitria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe INSTAT.

1.3.1. Metodologjia kuantitative

Për të matur fenomenin e rrezikut të pashtetësisë në Shqipëri, u përdorën gjithashtu metoda kuantitative.

Ashtu siç u përmend më lart, natyra e padukshme e pashtetësisë në terma ligjorë e bën mbledhjen e të dhënave rreth saj shumë të vështirë. Përkufizimi i pashtetësisë është kompleks dhe është shpesh e vështirë të përcaktosh nëse një individ nuk ka shtetësi, është në rrezik pashtetësie apo nuk ka dokumentet përkatëse.

Për më tepër, pothuaj gjysma e individëve në rrezik pashtetësie në Shqipëri janë pjesë të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, të cilët, në mënyrë të kuptueshme, nuk janë gjithmonë të gatshëm të bashkëpunojnë me realizuesit e këtyre studimeve.

Përsa i përket të dhënave zyrtare, Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT)⁸ është një burim informacioni. Të dhënat më të fundit në këtë drejtim janë mbledhur nga çensusi i popullsisë në 2011. Në këtë çensus, numri i të pargjistruarve u llogarit 7443. E vetmja e dhënë demografike për këtë numër i referohet ndarjes gjinore, me 3874 meshkuj dhe 3569 femra. Për t'u theksuar është mungesa e informacionit mbi fëmijët në rrezik pashtetësie. Të dhënat më të sakta rreth numrit të tanishëm të personave në rrezik pashtetësie janë mbledhur nga personeli i TLAS falë punës që ky i fundit ka bërë për të konfirmuar shtetësinë e personave në kërkim të ndihmës juridike falas gjatë viteve 2012 – 2016 (pas çensunit). Është vlerësuar se numri i personave në rrezik pashtetësie është ulur përafërsisht në 4971.

Sipas databazës së TLAS-it, rrethet ku problemi ishte më i prekshëm — dhe ku, logjikisht, projekti i hartëzimit u fokusua, ishin Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, dhe 61 bashkitë e tyre, Belsh, Berat, Bulqizë, Cërrik, Delvinë, Devoll, Dibër, Divjakë, Dropulli, Durrës, Elbasan, Fier, Finiq, Fushë-Arrëz, Gjirokastrë, Gramsh, Has, Himarë, Kamëz, Kavajë, Këlcyrë, Klos, Kolonjë, Konispol, Korçë, Krujë, Kuçovë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Libohovë, Librazhd, Lushnjë, Malësi e Madhe, Maliq, Mallakastër, Mat, Memaliaj, Mirditë, Patos, Peqin, Përmet, Pogradec, Poliçan, Prrenjas, Pukë, Pustec, Roskovec, Rrogozhinë, Sarandë, Selenicë, Shijak, Shkodër, Skrapar, Tepelenë, Tiranë, Tropojë, UraVajgurore, Vau-Dejë, Vlorë, Vorë dhe njësitë vendore administrative përkatëse.

⁸ <http://www.instat.gov.al/en/>

Analisti i të dhënave të TLAS zhvilloi një databazë të veçantë për këtë studim më anë të së cilës 1031 individë në rrezik pashtetësie u identifikuan. Databaza e menaxhimit të rasteve të TLAS lejoi organizimin e të dhënave duke përfshirë moshën, gjininë, pengesat për regjistrim, veprimet e ndërmarra etj. Më shumë informacion dhe analiza mbi këto raste mund të gjenden në kapitullin 5.

1.3.2. Metodologjia kualitative

Për të kuptuar shkaqet pas pashtetësisë ose rrezikut të ekspozimit ndaj saj në Shqipëri, u ndërmorr një punë kërkimore kualitative me anë të anketave, intervistave dhe fokus grupeve:

- 1) Me individët në rrezik pashtetësie.
- 2) Me aktorë të ndryshëm të përfshirë në një farë mënyre në parandalimin e këtij fenomeni.

1) 11 individë dhe familjet e tyre u intervistuan.

Një pyetësor gjysëm i strukturuar u përgatit për të fiksuar elementët e rëndësishëm të historisë të secilit individ: shiko Anekset 1 dhe 2.

2) Pyetësorët, intervistat dhe fokus grupet u përdorën për të identifikuar praktikën ekzistuese në Shqipëri. Veçanërisht, pyetësorët u shpërndanë në çdo njësi administrative, shërbim social brenda bashkisë, zyrë gjendje civile, njësi të mbrojtjes së fëmijës, drejtori vendore arsimit, qendër shëndetësore dhe stacion policie në kufi.

Pyetjet e ngritura për të intervistuarin përfshinin dhe ato mbi rolin, kontaktet, informacionin mbi rrezikun e pashtetësisë dhe, më e rëndësishme, dijeninë e tij mbi shkaqet pas mungesës së regjistrimit të individëve përkatës.

Të intervistuarit u pyetën dhe për opinionin e tyre dhe sugjerime që mund të kishin për parandalimin e pashtetësisë në Shqipëri. Nuk u lanë pa diskutuar dhe problemet praktike apo administrative të procedurave.

2. PASHTETËSIA NË BOTË

2.1. Përmbledhje e situatës së pashtetësisë në botë

Të mospaturit shtetësi do të thotë, praktikisht, për një person të mos ketë njohjen ose mbrojtjen e asnjë vendi. Pa mbrojtjen që ofron shtetësia, individët pa shtetësi janë shumë vulnerabël ndaj diskriminimit dhe abuzimit dhe shpesh i mohohen të drejtat bazike nga shteti ku jetojnë. Shumë njerëz pa shtetësi tentojnë të mos identifikohen për frikën e trajtimit negativ ose të përjashtimit nga ky vend. Për këtë arsye, është shumë e vështirë të caktosh një numër të saktë të njerëzve pa shtetësi sot në botë. Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) vlerëson se ka më shumë se 10 milionë njerëz pa shtetësi në glob, nga të cilët 3.5 milionë gjenden në vende ku ka statistika të besueshme për individët pa shtetësi (vetëm 55 shtete i raportojnë UNHCR mbi situatën dhe të dhënat e tyre mbi pashtetësinë). Nga ky numër, pothuaj një e treta janë fëmijë⁹.

Kudo në botë, nuk është rastësi që vendet me numrin më të madh të njerëzve pa shtetësi janë ose vende në konflikt ose shtete që po dështojnë.

Instituti mbi Pashtetësinë dhe Gjithëpërfshirjen liston 20 vende me një numër të individëve pa shtetësi mbi 20.000 — duke përfshirë Poloninë, Gjermaninë dhe Suedinë. Sidoqoftë, ky institut pranon që shifrat zyrtare janë vetëm një anë e historisë dhe shumë raste pashtetësie nëpër botë nuk identifikohen apo regjistrohen zyrtarisht¹⁰. Nga këto të dhëna mund të shihet se mbi 97% e rasteve zyrtarisht të identikuara të pashtetësisë gjenden vetëm në 20 vende.

Sidoqoftë raporti pohon se “Në terma numrash absolutë, shumica e personave që UNHCR raporton si pashtetësi mund të gjenden në Azi dhe Pacifik.” Në terma kontinentesh, Afrika është kontinenti i dytë me numrin më të lartë të personave pa shtetësi, i ndjekur nga Europa. Në rrafsh shtetesh, nga 20 shtetet me popullsinë më të lartë të individëve pa shtetësi, shtatë janë në Europë, gjashtë në Azi dhe Pacifik, katër në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut, dy në Afrikë dhe një në kontinentin amerikan.

Marrë së bashku, rajoni Azi-Pacifik ka jo vetëm numrin më të madh të rasteve të identikuara të pashtetësisë po dhe të çështjeve të paidentikuara. Megjithatë duhet pasur parasysh që ky rajon është dhe më i populluari i botës në terma absolutë, niveli i pashtetësisë në të mbetet çështje shqetësuese. Në anën tjetër, Amerikat kanë nivelin më të ulët të personave pa shtetësi, ku shumica e rasteve gjendet

⁹ <http://www.unhcr.org/statelessness-around-the-world.html>

¹⁰ <http://www.institutesi.org/worldsstateless.pdf>

vetëm në një shtet, Republikën Domenikane. Nuk mund të jetë rastësi që në këtë kontinent norma ligjore për fitimin e shtetësisë është jus soli, dmth., fëmijët e lindur në një territor fitojnë automatikisht shtetësinë e atij territori.

2.2. Përkufizime

Neni 1 i Konventës për Statusin e Personave Pa Shtetësi (1954) e përkufizon një individ pa shtetësi si “një person që nuk konsiderohet shtetas i asnjë vendi nga aplikimi i ligjit të këtyre vendeve.” Autorët e kësaj konvente besonin se ky përcaktim do të përfshinte pothuaj të gjithë individët që nuk njiheshin si refugjatë dhe nuk merrnin mbrojtje ndërkombëtare nëpërmjet Konventës së Refugjatëve (1951).

Komisioni Ndërkombëtar i Ligjit arriti në përfundimin se përkufizimi i Konventës në 1954 për personat pa shtetësi mund “të konsiderohet se ka fituar një natyrë zakonore” dhe është i detyrueshëm për çdo shtet sepse të gjithë shtetet kanë për detyrë të pranojnë dhe të veprojnë sipas një principi që ka arritur statusin e të drejtës ndërkombëtare zakonore edhe kur një shtet nuk ka ratifikuar një traktat të veçantë për çështjen në fjalë. Jo të gjithë shtetet bien dakord që përcaktimi i nenit 1 përbën një princip të së drejtës zakonore. Sidoqoftë, fakti që të paktën disa nga autoritetet ndërkombëtare ligjore kanë pranuar këtë status të këtij përkufizimi tregon rëndësinë e tij.

Sipas përkufizimit të Konventës të 1954, për të përcaktuar nëse një individ “nuk konsiderohet si shtetas” nuk mjafton studimi i ligjit mbi shtetësinë e vendit përkatës, por duhen parë edhe praktikat e zbatimit të këtyre ligjeve. Për të qenë një shtetas sipas këtij përkufizimi nevojitet vetëm një lidhje formale, e cila nuk ka pse të provokojë mekanizma të tjera, midis individit dhe shtetit. Pra, individivët që do të kishin këtë lidhje formale me një shtet, edhe kur të mos gëzonin të njëjtat të drejta dhe mbrojtje si shtetasit e tjerë të atij shteti, nuk do të konsideroheshin si pa shtetësi. Sidoqoftë, persona të tillë do të ishin vulnerabël ndaj të njëjtave tipe problemesh si personat pa shtetësi dhe për pasojë duhet të trajtohen si këta të fundit. Në të njëjtën kohë, përcaktimi i Konventës për personat pa shtetësi synon që të jetë gjithpërfshirës dhe të prekë një pjesë sa më të madhe të këtyre njerëzve në mënyrë që t’i sigurojë atyre mbrojtjen e nevojshme.

Shumë prej nesh janë mësuar të gëzojnë të drejta të tilla sociale, politike dhe ekonomike që konsiderohen të pandashme nga njeriu. Gjithsesi duhet kuptuar që këto të drejta i garantohen vetëm shtetasve të një vendi.

2.3. Shkaqet e pashtetësisë

Pashtetësia mund të vijë prej disa arsyeve, ku në mes të tjerave përmendim ndryshimin e kufijve, mungesën e sigurive në legjislacionet përkatëse për parandalimin e pashtetësisë, procedurat e papërshtatshme për regjistrimin e lindjeve, etj. Nganjëherë ligjet vendase ose (mos)përputhshmëria e ligjeve të

vendeve të ndryshme janë përgjegjëse ashtu si po shihet në mënyrë të shpeshtë këto kohë, ku fëmijët e refugjatëve janë veçanërisht të rrezikuar.

Kufijtë botërorë janë në ndryshim të vazhdueshëm. Shpërbërja e shteteve të vjetër dhe krijimi i atyre të rinj sjell, në mënyrë të paevitueshme, që një numër njerëzish që ishin shtetas të atij vendi të mbeten pa shtetësi.

Popullsia e njerëzve pa shtetësi është rritur dhe si pasojë e problemeve historike dhe moderne. Jetimët, fëmijët e birësuar jashtë vendit dhe, së fundmi, fëmijët e lindur me anë të surrogacisë janë në rrezik të veçantë për shkak të boshllëqeve në sistemin ligjor.

Fatkeqësisht, një grup i madh personash pa shtetësi vuajnë nga ky problem për shkak të diskriminimit. Ata mund të ndeshen me një trajtim indiferent, madje dhe armiqësor, kur shkojnë për të regjistruar një lindje apo në procedurë të tjera të lidhura me njohjen e shtetësisë.

Nga shkaqet e sipërpërmendura është e qartë që problemet e pashtetësisë mund të fillojnë në moshë të hershme për një person, shpesh që në lindje. Në raportin “Fëmijët refugjatë pa shtetësi — Një përmbledhje e shkurtër e politikave dhe praktikave të pashtetësisë në Spanjë¹¹,” Aleksandra Semeriak vlerëson se, “Disa vende e bëjnë të pamundur për prindërit pa shtetësi ose që nuk mund të provojnë identitetin e tyre për të regjistruar lindjen e fëmijëve, e cila është arsye kryesore pse fëmijë pa shtetësi nuk mund të marrin një dokument identifikimi apo një pashaportë — një instrument bazë për të aksesuar të drejtat e tyre për edukim apo shëndetësi. Pasojat e kësaj situate janë shumë të rënda.”

Gjithashtu nuk janë të pazakonta rastet kur ligjet e shtetësisë pengojnë mamatë t’i kalojnë shtetësinë e tyre fëmijëve. Për shembull, janë dymbëdhjetë vende në Lindjen e Mesme, duke përfshirë Sirinë, ku vetëm babai mund të kalojë shtetësinë e tij fëmijëve. Për më tepër, shumë çifte mund të mos kenë dokumentet zyrtare që provojnë martesën e tyre apo t’i kenë humbur këto dokumenta gjatë zhvendosjeve, që janë të zakonshme në këto shtete.

Faktorët kryesorë pas pashtetësisë janë përmbledhur në raportin e UNHCR “Shtetas të Askundit¹²”:

- **Ndryshimi i kufijve**
- **Diskriminimi dhe mohimi arbitrar i shtetësisë**
- **Shkaqe teknike**

Shpesh këto tre shkaqe mbivendosen.

¹¹ <https://www.statelessness.eu/blog/child-refugees-without-nationality-short-overview-statelessness-spain>

¹² Faqja 13 e raportit. <http://www.refworld.org/docid/50c620f62.html>

Ndryshimi i kufijve ndodh kur dy ose më shumë shtete bashkohen për të formuar një shtet të ri ose kur pjesë përbërëse të një shteti ndahen për të formuar vende të rinj. Në këto raste, shumë njerëz kanë nevojë të formalizojnë shtetësinë e tyre në shtetin e ri. Shpesh ky proces në një periudhë tranzicioni mund të jetë i komplikuar dhe i ngadaltë, ndonjëherë duke zgjatur përgjithmonë.

Historikisht, rishikimi i kufijve ka sjellë probleme të mëdha me pashtetësinë. Që nga Lufta e Dytë Botërore, më shumë se 100 shtete të rinj janë formuar dhe pothuaj gjithmonë kjo ka sjellë probleme afatshkurtër ose afatgjatë pashtetësie prej burokracisë ose politikave të aplikuara.

Pas adoptimit në masë të Konventave të OKB (1954 dhe 1961), pashtetësia nuk shikohej më si çështje shqetësuese. Sidoqoftë, ndarja e Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë në vitet 90' e ritheksoi rëndësinë e këtij fenomeni dhe problemet që e ndjekin.

Gjatë 20 viteve të fundit, kufijtë kanë vazhduar të ndryshojnë dhe shtete të rinj të formësohen, psh. Republika e Sudanit të Jugut në 2011. Secili nga këto ndryshime ka pasur një impakt te shtetasit dhe nëse motori i ndryshimit është furnizuar nga diferencat dhe ndarjet, atëherë pashtetësia është shoqëruar me diskriminim dhe mungesë vullneti për ta adresuar.

Diskriminimi dhe mohimi arbitrar i shtetësisë. Diskriminimi mund të jetë një tjetër shkak pas pashtetësisë. Nëse një grup i caktuar trajtohet në një mënyrë për shkak të etnicitetit, racës, fesë, etj., ky grup mund të marginalizohet, izolohet ose përjashtohet. Të gjitha këto mund të sjellin një distancim të forcuar ose të vetë-vendosur nga pjesa tjetër e shoqërisë. Diskriminimi gjinor është i lidhur drejtpërdrejtë me pashtetësinë. Ashtu siç u tha më lart, ekzistojnë legjislacione që ndalojnë kalimin e shtetësisë nga nëna te fëmija dhe e lejojnë këtë proces vetëm për babain. Çdo problem me atësinë ose mungesa e babait mund të rezultojnë lehtësisht në një fëmijë të paregjistruar.

Shkaqe teknike është një term që referon të gjitha rastet e pashtetësisë që rrjedhin nga problemet e ligjit të shtetësisë të një vendi, mospërputhjet e legjislacioneve të vendeve të ndryshme ose veprimet dhe mosveprimet e individëve. Një shembull i përhapur i këtyre rasteve është mospërputhja midis legjislacioneve që njohin *jus sanguinis* (shtetësi me anë të lidhjes së gjakut) dhe atyre që njohin *jus soli* (shtetësi prej lindjes në një territor). Ka pasur shumë raste kur një fëmijë i kualifikueshëm për shtetësi në një vend, bazuar në lidhjet e tij të gjakut, i është mohuar kjo për shkak se ligji i shtetësisë i atij vendi është ndërtuar sipas principeve *jus soli*. Në mënyrë të ngjashme, një fëmijë i lindur në territorin e një shteti por pa lidhje gjaku me shtetasit e tij mund të mos marrë shtetësi për shkak se ky shtet funksionon në bazë të normës *jus sanguinis*.

Të tjerë faktorë teknikë që mund të sjellin pashtetësinë që në lindje ose më vonë përfshijnë heqjen e shtetësisë së individëve që jetojnë jashtë dhe nuk plotësojnë kriteret e regjistrimit, braktisjen e fëmijëve,

komplikime që mund të lindin pas martesë kur një shtetësi e re nuk mund të lëshohet dhe e vjetra konsiderohet e humbur.

Shumë vende kanë kërkesa strikte lidhur me provat e pranueshmërisë për një shtetësi. Një personi mund t'i kërkohej të plotësojë disa ose të gjitha kushtet e mëposhtme: çertifikatë regjistrimi lindje, provë shtetësie, provë të lidhjeve familjare (ndonjëherë edhe teste të shtrenjta ADN), tarifa të larta regjistrimi, etj. Grupe të tërë individësh mund të mos jenë në gjendje t'i plotësojnë këto kushte për shkak të pamundësive financiare ose stilit të jetesës në lëvizje (endacake) që i le ata pa dokumentat e kërkuar. Normalisht, fëmijët e pa dokumentuar duhet të kenë një shtetësi, por ata mund të ngelen pa të nëse nuk i përmbushin kushtet e vendosura nga vendi i tyre.

2.4. Pasojat e pashtetësisë

Shtetësia shpesh përcaktohet si e drejta e parë nga e cila rrjedhin të gjithë të drejtat e tjera. Pa një njohje formale, një person mund mos të ketë akses në të drejta të tjera të domosdoshme, pra të jetë në njëfarë mënyre i padukshëm.

Instituti mbi Pashtetësinë dhe Gjithëpërfshirjen shprehet si me poshtë për këtë fenomen¹³:

“Realiteti i dhimbshëm me të cilin përballen personat pa shtetësi është ai i mungesës së mundësive, mbrojtjes të drejtave të njeriut dhe pjesëmarrjes aktive sociale. Këta njerëz përballen me sfida në të gjitha fushat e jetës, përfshirë aksesin në arsim dhe shëndetësi, punësimin, blerjen apo trashëgimin e një prone, regjistrimin e një biznesi apo makine, marrjen e një çertifikate lindje, patente, çertifikate martesë apo vdekje, hapjen e një llogarie bankare, marrjen e një huaje dhe marrjen e një pensioni. Pajisja me një pashaportë apo çfarëdoq dokumenti identiteti, bëhen aq të vështira si proçese sa shumë njerëz pa shtetësi nuk kanë asnjë provë të ekzistencës së tyre me të cilën të identifikojnë veten në ndërveprimet ditore me organizata shtetërore ose private.”

Pasojat e pashtetësisë te individit ndjehen në jetën e përditshme. Çdo ndërveprim me autoritete ose agjenci shtetërore është problematik, i rrezikshëm dhe, ndonjëherë, i pamundur. Pa njohjen formale të shtetit të individit, këtij të fundit mund t'i mohohen aksesin në edukim, shëndetësi, mbështetjen publike në formë shërbimesh, në tregun e punës, të drejtat për të pasur pronë dhe llogari bankare. Këta persona nuk janë të lirë as të martohen.

Çdo problem ose dëmshpërblim ligjor që ata mund të kërkojnë mund t'i mohohet pasi aksesin në drejtësi është gjithashtu i varur nga shtetësia. Nëse këta persona janë viktima të një krimi, ata mund të mos jenë në gjendje ose të përgatitur për ta adresuar tek autoritetet përkatëse.

¹³ <http://www.institutesi.org/world/impact.php>

Lëvizja e lirë është po ashtu e limituar për këta individë. Ata mund ta kenë të vështirë, shpesh të pamundur, të pajisen me një pashaportë, prandaj kalimi i kufirit mund t'i ndalohet dhe përpjekja mund të shoqërohet me dëbim. E vetmja mundësi ngelet lëvizja e paligjshme që i kthen ata vulnerabël ndaj rreziqeve të mëdha personale. Lëvizja e lirë e personave pa shtetësi mund të jetë e limituar dhe brenda një shteti.

Nga ana psikologjike, individi pa shtetësi mund të ndjehet i paplotësuar ose i marginalizuar. Ata bëhen pre, më shpesh se të tjerët, të shqetësimeve psikologjike si ankthi dhe depresioni.

3. KUADRI LIGJOR NDËRKOMBËTAR DHE RAJONAL

3.1 Ligji Ndërkombëtar mbi Pashtetësinë

Konventa e vitit 1954 për “Statusin e Personave Pa Shtetësi” dhe Konventa e vitit 1961 “Për Reduktimin e Pashtetësisë” janë konventat kryesore ndërkombëtare që adresojnë pashtetësinë. Ato plotësohen nga traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe dispozitat që lidhen me të drejtën për shtetësi.

Midis 2011 dhe 2015, ka pasur 49 aderime në dy Konventat mbi Pashtetësinë — një rritje që do të çojë në më shumë veprime për të mbrojtur njerëzit pa shtetësi, zgjidhjen e situatës së tyre dhe parandalimin e rasteve të reja.

Përveç kësaj, nene të tjera themelore që kanë të bëjnë me pashtetësinë janë:

Neni 15 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, në të cilën thuhet se “çdokush ka të drejtën të ketë shtetësi” dhe se “[as]një person nuk duhet të privohet arbitrarisht nga shtetësia e tij dhe nuk duhet t’i mohohet e drejta për të ndryshuar shtetësinë e tij.”

Neni 7 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës thekson se çdo fëmijë ka të drejtën të fitojë një shtetësi.

Neni 5 i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor kërkon që Shtetet të “ndalojnë dhe të eliminojnë diskriminimin racor në të gjitha format e tij dhe të garantojnë të drejtën e gjithsecilit, pa dallim race, ngjyre, origjine kombëtare ose etnike, për barazinë para ligjit, sidomos në gëzimin e të drejtave të mëposhtme. . . e drejta për shtetësi.”

3.1.1 Konventa të veçanta për pashtetësinë¹⁴

Konventa e vitit 1954 u hartua për të siguruar që njerëzit pa shtetësi të gëzonin një numër minimal të të drejtave të njeriut. Ajo përcakton përkufizimin ligjor të një personi pa shtetësi si një person që «nuk njihet si shtetas nga ndonjë shtet nën veprimin e ligjit të tij». E thënë thjeshtë, kjo do të thotë që një person pa shtetësi është dikush që nuk ka shtetësinë e ndonjë vendi. Konventa e vitit 1954 gjithashtu

¹⁴ UNHCR, Konventa mbi Pashtetësinë, <http://www.unhcr.org/un-conventions-on-statelessness.html>

përcakton standardet minimale të trajtimit të personave pa shtetësi në lidhje me një numër të drejtave. Këto përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në të drejtën për arsim, punësim dhe strehim. Konventa e vitit 1954 u garanton gjithashtu njerëzve pa shtetësi të drejtën për identitet, dokumente udhëtimi dhe ndihmë administrative.

Në nëntor të vitit 2014, kur ekipet e UNHCR nisën fushatën për t'i dhënë fund pashtetësisë në 10 vjet, ishin 83 shtete pjesëmarrëse në Konventën e 1954.

Konventa e vitit 1961 synon të parandalojë pashtetësinë dhe ta zvogëlojë atë me kalimin e kohës. Ajo krijon një kuadër ndërkombëtar për të siguruar të drejtën e çdo personi për një shtetësi. Konventa kërkon që shtetet të krijojnë masa mbrojtëse në ligjet e tyre për shtetësinë për të parandaluar pashtetësinë në lindje dhe më vonë gjatë jetës. Dispozita (ndoshta) më e rëndësishme e konventës përcakton se fëmijët duhet të fitojnë shtetësinë e vendit ku lindin, nëse nuk fitojnë asnjë shtetësi tjetër. Ajo gjithashtu përcakton masa mbrojtëse të rëndësishme për të parandaluar pashtetësinë për shkak të humbjes së saj ose të heqjes dorë nga shtetësia ose në rast ndryshimi kufijsh. Konventa gjithashtu përcakton situata shumë të rralla në të cilat shtetet mund të privojnë një person nga shtetësia e tij/saj, edhe nëse në saj të këtij veprimi do t'i linte ata pa shtetësi.

Në nëntor të vitit 2014, kur ekipet e UNHCR nisën fushatën për t'i dhënë fund pashtetësisë në 10 vjet, ishin 61 shtete pjesëmarrëse në Konventën e 1961.

3.1.2. Instrumente të tjera ligjore për pashtetësinë në ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut¹⁵

E drejta për një shtetësi njihet në një sërë instrumentesh ligjore ndërkombëtare, duke përfshirë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën mbi të Drejtat të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Konventën mbi Shtetësinë e Grave të Martuara, Konventën mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarët e Familjeve të tyre. Çështja e shtetësisë rregullohet gjithashtu në Konventën për Reduktimin e Pashtetësisë, Konventën për Statusin e Personave pa Shtetësi dhe Konventën për Statusin e Refugjatëve.

Një ndalim i qartë dhe i përgjithshëm për privimin arbitrar të shtetësisë mund të gjendet në shumë instrumente ndërkombëtare. Në veçanti, vlen të përmendet se neni 15 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut në mënyrë të drejtpërdrejtë parashikon që askush nuk duhet të privohet arbitrisht nga kombësia e tij/saj. Asambleja e Përgjithshme, në Rezolutën e saj 50/152, gjithashtu njohu natyrën themelore të ndalimit të privimit arbitrar të shtetësisë.

¹⁵ <http://www.ohchr.org/EN/Issues/Pages/Nationality.aspx>

3.2 Pashtetësia në Ligjin Rajonal

Brenda Europës ekzistojnë një sërë ligjesh dhe konventash specifike që i shtohen ligjeve ndërkombëtare mbi pashtetësinë. Më e rëndësishmja nga këto burime janë konventat e Këshillit të Europës.

Një nga aksionet e para të Këshillit të Europës, të posaformuar në 1950, ishte përgatitja e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Kjo konventë erdhi në fuqi në shtator të 1953 për anëtarët ekzistues dhe të gjithë anëtarët e rinj priten ta nënshkruajnë dhe ratifikojnë në mundësinë e parë të mundshme. Konventa i dha udhë ngritjes së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në mënyrë që çdo person që mendon se të drejtat e tij/saj themelore janë prekur mund të kërkojë një gjykim që është i detyrueshëm për çdo shtet pjesëmarrës.

Konventa Europiane për Shtetësinë, e cila hyri në fuqi në mars të vitit 2000 dhe që më pas rrjedhimisht u nënshkrua dhe ratifikua nga Shqipëria. Neni 6 shprehimisht kërkon që nënshkruarit të «lehtësojnë» fitimin e shtetësisë dhe i referohen shprehimisht personave pa shtetësi. Neni 5 ndalon çdo formë diskriminimi në ligjin e shtetësisë të një vendi që ka lidhje me seksin, fenë, racën, ngjyrën, origjinën kombëtare ose etnike.

Instrumenti i dytë i Këshillit të Europës është Konventa për Shmangien e Pashtetësisë në Lidhje me Ndryshimet e Kufijve, e miratuar në vitin 2006. Kjo Konventë gjithashtu shprehimisht ndalon diskriminimin (neni 4) dhe neni 3 përcakton që shtetet duhet të kenë një qëllim të qartë: «Eliminimi i pashtetësisë duhet të arrihet me zbatimin e grupit të parimeve dhe rregullave që përmban Konventa». Megjithatë, deri në datën e hartimit të këtij raporti, Shqipëria nuk është nënshkruese e kësaj Konvente.

Institucionet e tjera rajonale gjithashtu kanë vendosur ligje dhe konventa që u bëjnë thirrje shteteve të veprojnë për t'i dhënë fund pashtetësisë në një mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Mund të përmendim veçanërisht jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, ligj me formë jo detyruese (pra rekomandues) nga OSBE-ja, të drejtat e pakicave dhe ligji kundër diskriminimit nga Bashkimi Evropian dhe këshilla kushtetuese nga Komisioni i Venecias i KE-së.

3.3. Roli dhe mandati i UNHCR për pashtetësinë

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara vendosi të krijojë një zyrë të Komisionerit të Lartë për Refugjatët që nga 1 janari 1951. Statuti i Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët u miratua nga Asambleja e Përgjithshme (AP) më 14 dhjetor 1950 si Shtojcë e Rezolutës 428 (V)¹⁶.

¹⁶ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Statuti i Zyrës së Komisionerit të Lartë për Refugjatët, 14 dhjetor 1950, A/RES/428(V), <http://www.refworld.org/docid/3ae6b3628.html>

UNHCR ishte mandatar nga AP për të siguruar mbrojtje ndërkombëtare dhe për të kërkuar zgjidhje të përhershme për refugjatët. Përveç kësaj, UNHCR-së iu dha një përgjegjësi mbikëqyrëse për zbatimin e Konventës së vitit 1951 lidhur me Statusin e Refugjatëve¹⁷, e cila është përcaktuar qartë në paragrafin 8 (a) të Statutit, nenin 35 të Konventës së vitit 1951 dhe nenit II të Protokollit të vitit 1967. Pra, Komisioneri i Lartë për Refugjatët ka përgjegjësi për refugjatët që janë pa shtetësi, në përputhje me paragrafin 6 (A) (II) të Statutit dhe nenin 1 (A) (2) të Konventës së vitit 1951.

Megjithatë, UNHCR nuk u përmend në mënyrë eksplicite në Konventën e vitit 1954 lidhur me Statusin e Personave pa Shtetësi ose Konventën e vitit 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë.

Për të kryer funksionet e parashikuara nga nenet 11 dhe 20 të Konventës së vitit 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë («Konventa 1961»), mandati i UNHCR u zgjerua për të mbuluar personat që bien nën kushtet e kësaj Konvente me Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme 3274 (XXIX) të vitit 1974 dhe 31/36 të vitit 1976. Zyrës i janë besuar përgjegjësi për personat pa shtetësi, përgjithësisht në bazë të Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme 50/152 të vitit 1995, e cila ka miratuar Konkluzionin Ekzekutiv të UNHCR 78. Më pas, në Rezolutën 61/137 të vitit 2006, Asambleja e Përgjithshme miratoi vendimin përfundimtar 106 të Komitetit Ekzekutiv, i cili përcakton katër fusha të përgjegjësisë të UNHCR: identifikimin, parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë dhe mbrojtjen e personave pa shtetësi¹⁸.

Në vitin 2014, UNHCR nisi një fushatë globale për t'i dhënë fund pashtetësisë deri në vitin 2024, pra 60 vjet pasi komuniteti ndërkombëtar ra dakord mbi Konventën e parë¹⁹ për të rregulluar statusin e personave pa shtetësi. Në këtë kontekst, *Plani Global i Veprimit për të Zhdukur Pashtetësinë 2014 - 2024*²⁰ (i referuar këndej e tutje si *Plani Global i Veprimit*) është zhvilluar në konsultim me Shtetet, organizatat e shoqërisë civile dhe ndërkombëtare dhe përcakton një kornizë udhëzuese për të adresuar pashtetësinë në mbarë botën. Plani Global i Veprimit përfshin 10 veprime që do të ndihmojnë Shtetet të përparojnë përkundrejt qëllimit të 2024:

- Veprimi 1: Zgjidhje e situatave ekzistuese madhore të pashtetësisë.
- Veprimi 2: Sigurim që asnjë fëmijë të mos lindë pa shtetësi.
- Veprimi 3: Heqja e diskriminimit gjinor nga ligjet e shtetësisë.
- Veprimi 4: Parandalimi i mohimit, humbjes ose heqjes së shtetësisë në baza diskriminuese.
- Veprimi 5: Parandalim i pashtetësisë në rastet e ndryshimeve të kufijve.
- Veprimi 6: Dhënia e një statusi mbrojtës për emigrantët pa shtetësi dhe lehtësimi i natyralizimit të tyre.
- Veprimi 7: Sigurim i regjistrimit të lindjes për parandalimin e pashtetësisë.

¹⁷ Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), Konventa e 1951 Për Statusin e Refugjatëve dhe Protokollin e 1967, shtator 2011, <http://www.refworld.org/docid/4ec4a7f02.html>

¹⁸ Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), Udhëzues për Mbrojtjen e Personave Pa Shtetësi, 30 qershor 2014, <http://www.refworld.org/docid/53b676aa4.html>

¹⁹ Asambleja e Përgjithshme, Konventa për Statusin e Personave Pa Shtetësi, 28 shtator 1954, Seritë e Traktateve të Kombeve të Bashkuara, vol. 360, f. 117, <http://www.refworld.org/docid/3ae6b3840.html>

²⁰ Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), Plani Global për të Zhdukur Pashtetësinë, 4 nëntor 2014, <http://www.refworld.org/docid/545b47d64.html>

- Veprimi 8: Lëshim i dokumentacionit të shtetësisë për ata që ligjet e parashikojnë se e kanë si të drejtë.
- Veprimi 9: Aderim në Konventat e Pashtetësisë të OKB-së.
- Veprimi 10: Përmirësim të të dhënave sasiore dhe cilësore për popullatën pa shtetësi.

Së bashku me Planin e Veprimit Global, UNHCR filloi fushatën *I belong* ("Unëpërkas") në 2014. Më 4 nëntor 2014, Komisioneri i Lartë i OKB për Refugjatët, Antonio Guterres, e Dërguara e Posaçme e UNHCR, Angelina Jolie dhe më shumë se 30 njerëz të famshëm dhe udhëheqës të opinionit publik botuan një Letër të Hapur për të eliminuar pashtetësinë. Letra e Hapur është e disponueshme në internet dhe fushata synon rritjen e vetëdijes për pasojat e pashtetësisë dhe promovimin e angazhimit global për t'i dhënë fund asaj.

Përmes *Planit të Veprimit Global*, UNHCR dhe partnerët e tij angazhohen të mbështesin shtetet për të arritur këtë qëllim përmes disa veprimeve, duke përfshirë: i) rritjen e identifikimit dhe grumbullimit të të dhënave në lidhje me popullsinë në rrezik të pashtetësisë, ii) zhvillimin e politikave, duke përfshirë Planet Kombëtare të Veprimit për reduktimin dhe parandalimin e pashtetësisë, iii) ofrimin e mbështetjes teknike për reformimin e legjislacionit primar dhe sekondar, iv) ofrimin e mbështetjes teknike për të hequr pengesat procedurale për konfirmimin e shtetësisë; v) mbështetjen ndaj qeverive për të përmirësuar procedurat dhe praktikën e regjistrimit të lindjes, vi) sigurimin e ndihmës juridike falas vii) mbështetjen ndaj qeverive për lëshimin e dokumentacionit, viii) mbështetjen me vendosjen e ekipeve lëvizëse për të siguruar që të gjithë personat pa shtetësi ose personat në rrezik të pashtetësisë të kenë qasje në procedurë, viii) nxitjen e shkëmbimit të praktikave të mira dhe ndarjen e mësimëve të nxjerra, ix) organizimin e fushatave sensibilizuese në lidhje me pashtetësinë, x) mbrojtjen dhe nxitjen e politikave, procedurave dhe praktikave jo-diskriminuese, dhe xi) mbështetjen ndaj qeverive për vendosjen e procedurave të përcaktimit të shtetësisë dhe garancinë që personat pa shtetësi të jenë në gjendje të kenë dhe të gëzojnë këto të drejta.

Për t'i dhënë fund pashtetësisë midis këtyre grupeve dhe personave të tjerë në rrezik në Europën Juglindore, UNHCR po punon me autoritetet dhe institucionet vendore për të zvogëluar numrin e personave pa shtetësi dhe/se personave në rrezik të pashtetësisë me anë të:

- Identifikimit/profilizimit dhe mbrojtjes të personave pa shtetësi, duke përfshirë edhe ata me një të kaluar migrimi;
- Përkrahjes për aderim në të dyja Konventat e Kombeve të Bashkuara për Pashtetësinë;
- Parandalimit të pashtetësisë në lindje;
- Bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile (në veçanti ofruesit e ndihmës juridike falas), Rrjetin European të Pashtetësisë (RrEP), agjensi të tjera të OKB-së dhe organizata të tjera ndërkombëtare, siç është OSBE dhe Këshilli i Europës. Këto objektiva janë pjesë e rëndësishme e strategjisë rajonale të

UNHCR e hartuar për të adresuar shkaqet themelore të pashtetësisë në rajon, përkatësisht marginalizimin e institucionalizuar të komuniteteve në rrezik, perspektivat e dobëta socio-ekonomike të personave të prekur në rajon dhe ritmin e ulët të reformave ligjore dhe të implementimit të tyre.

4. ANALIZA E KORNIZËS LIGJORE NË LIDHJE ME PASHTETËSINË NË SHQIPËRI

Është interesante që Weissbrodt dhe Collins i klasifikojnë masat për zgjidhjen e pashtetësisë në tri kategori: «masa parandaluese», të cilat përpiqen të parandalojnë pashtetësinë para se të zhvillohet; «masa minimizuese», të cilat lehtësojnë problemet që lidhen me pashtetësinë dhe shërbejnë për të mbrojtur personat pashtetësi; dhe «masa natyralizuese», të cilat përpiqen të sigurojnë shtetësinë për ata që tashmë janë pashtetësi²¹. Në Shqipëri vihet re një veçori domethënëse, dështimi për të trajtuar rastet e personave pa shtetësi ose ata në rrezik për të qenë pa shtetësi, por që nuk njihen si të tillë.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton të drejtat dhe liritë themelore të të huajve dhe personave pa shtetësi në territorin e saj. Në veçanti, ajo i jep të drejtën për shtetësi personave të lindur nga një prind shqiptar dhe garanton mbrojtje kundër humbjes së shtetësisë.

Ky seksion vlerëson përfshirjen e objektivave të Konventave të Pashtetësisë në legjislacionin shqiptar: në Ligjin për Shtetësinë (1999), Për të Huajt (2013), Për Statusin Civil (2009) dhe Për Kodin e Familjes (2003).

4.1. Përmbledhje e kuadrit ligjor të Shqipërisë dhe detyrimet ndërkombëtare

4.1.1. Detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë

Republika e Shqipërisë aderon që nga viti 2003 në të dyja Konventat e Kombeve të Bashkuara, për Statusin e Personave Pa Shtetësi (1954) dhe për Reduktimin e Pashtetësisë (1961)²².

Që nga viti 2002, Shqipëria aderon gjithashtu në Konventën Europiane për Shtetësinë (KESH)²³. Sidoqoftë, vendi ynë nuk është bërë pjesë e Konventës të Këshillit të Europës për Shmangien e Pashtetësisë në Lidhje me Ndryshimet e Kufijve.

21 D.S. Weissbrodt and C. Collins, "The Human Rights of Stateless Persons [Të Drejtat e Njeriut për Personat Pa Shtetësi]", Human Rights Quarterly 28, nr. 1 (2006), 271.

22 Ligji nr. 9057, datë 24.4.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Statusin e Personave pa Shtetësi."

Ligji nr. 9059, datë 8.5.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Reduktimin e Pashtetësisë."

23 Ligji nr. 8942, datë 19.9.2002, "Për ratifikimin e Konventës Europiane për Shtetësinë."

Po ashtu, Shqipëria ka një traditë të gjatë për aderimin në traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat janë shumë të rëndësishëm për parandalimin e pashtetësisë dhe mbrojtjen e individëve pa shtetësi. Këto përfshijnë Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF), ku Shqipëria aderoi në 1991²⁴, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP), gjithashtu e aderuar në 1991²⁵, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (KEDR)²⁶ dhe Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave (KEDNG)²⁷, të dyja të nënshkruara në 1993, dhe Konventa e OKB mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDKPAK), aderuar në 2012²⁸. E fundit, duke filluar nga viti 1996, Shqipëria ka qenë pjesë e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ)²⁹.

Detyrimet e Shqipërisë nën këto pakte përfshijnë të drejtat e minoriteteve, parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë, kryesisht me anë të ofrimit të dokumentave dhe regjistrimit të lindjeve për të gjithë. Për shembull, neni 7 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës detyron shtetet pjesëmarrëse të regjistrojnë çdo fëmijë menjëherë pas lindjes dhe të sigurohen që asnjë fëmijë nuk ngel pa shtetësi. Në mënyrë të ngjashme, neni 5 (d) (iii) i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor ndalon diskriminimin racor dhe etnik për sa i përket të drejtës për shtetësi. Rrjedhimisht, këto traktate shërbejnë si mekanizma për t'u siguruar që Shqipëria po përmbush detyrimet e saj që rrjedhin nga ligji ndërkombëtar.

4.1.2. Hierarkia e normave ligjore në Shqipëri

Kushtetuta e Shqipërisë parashikon hierarkinë, statusin dhe efektin e normave ligjore. Në veçanti, neni 4/2 parashtron se “Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.”

Neni 116 i Kushtetutës paraqet hierarkinë e normave ligjore, duke u shprehur se “aktet normative që veprojnë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë: a) Kushtetuta; b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; c) ligjet; d) aktet normative të Këshillit të Ministrave.”

Nga kjo rrjedh që marrëveshjet ndërkombëtare vijnë të dytat, vetëm pas Kushtetutës për sa i përket renditjes së normave ligjore.

Neni 122 i Kushtetutës së Shqipërisë e rithekson këtë ide duke parashikuar që marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara sipas ligjit, dominojnë ligjet vendase që nuk përputhen me to³⁰. Rrjedhimisht, aktet ndërkombëtare të sipërpërmendura konsiderohen pjesë e legjislacionit shqiptar, që ashtu si një

24 Ligji nr. 7531, datë 11.12.1991, “Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës”

25 Ligji nr. 7510, datë 13.8.1991, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.”

26 Ligji nr. 7768, datë 9.11.1993, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor.”

27 Ligji nr. 7767, datë 9.11.1993, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave.”

28 Ligji nr. 108/2012, datë 15.11.2012, “Për ratifikimin e Konventës së OKB mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.”

29 Ligji nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.”

30 Manuali i Përgatitjes së Ligjit Euralius: Një Udhëzues i Proçesit Legjislativ në Shqipëri, 2006, www.euralius.eu/en/archive-2?doen-load=74:law-drafting-manual

numër i rëndësishëm aktesh ndërkombëtare për mbrojtjen ndaj pashtetësisë kanë fuqi vepruese në vend³¹.

4.2. Regjimi ekzistues mbi shtetësinë në Shqipëri

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton të drejtat dhe liritë themelore të të huajve dhe personave pa shtetësi në territorin e saj. Gjithashtu, ajo i jep të drejtën e shtetësisë çdo personi që ka të paktën një prind shqiptar dhe ofron garanci kundër humbjes së shtetësisë.

Fitimi dhe heqja dorë nga shtetësia shqiptare rregullohet nga Ligji nr. 8389, i datës 5 gusht 1998 “Për Shtetësinë” i ndryshuar nga Ligji nr. 8442 i datës 21 janar 1999³². Ndryshimet më të fundit legjislative në këtë fushë janë ato të bëra me anë të reformave në vitin 1999.

Në vitin 1998, UNHCR-së iu besua nga Komiteti Ekzekutiv dhe Asambleja e Përgjithshme t’i ofronte shërbime teknike dhe këshilluese shteteve të interesuara për përgatitjen dhe implementimin e ligjit të shtetësisë. Pas shqyrtimit të projekt-ligjit për shtetësinë në Shqipëri, UNHCR vlerësoi që “ishte i një standardi të lartë dhe në princip realizonte qëllimin kryesor, zhdukjen e pashtetësisë³³.” Fatkeqësisht, ashtu si do të shpjegojmë më pas, ka boshllëqe të rëndësishme midis kuadrit ligjor në teori dhe funksionimit në praktikë të institucioneve shqiptare³⁴.

4.2.1. Një kombinim i principeve jus soli dhe jus sanguinis

Ligji nr. 8442 parashikon se “çdokush që ka të paktën një prind me shtetësi shqiptare fiton në mënyrë automatike shtetësinë shqiptare.” Ky ligj gjithashtu parashtron se një fëmijë i lindur në territorin e Republikës së Shqipërisë nga prindër me tjetër shtetësi, por që janë banues të ligjshëm në Shqipëri, mund të fitojë shtetësinë shqiptare nëse të dy prindërit e pranojnë. Në këtë rast, procedura që duhet ndjekur është e njëjtë si me çdo lindje nga prindër shqiptarë në territorin e Republikës së Shqipërisë; zyra e gjendjes civile kërkon një provë të vendbanimit të ligjshëm të prindërve dhe një certifikatë lindje nga spitali.

Pra, sipas ligjit shqiptar, kombësia bazohet dhe në lidhje gjaku dhe me lindjen brenda territorit të Shqipërisë, *jus sanguinis* dhe *jus soli*. Shtetësia shqiptare jepet duke ndjekur regjistrimin e lindjes. Në aplikimin e principit *jus sanguinis*, fëmija do të regjistrohet si shtetas shqiptar, me kusht që të provohet lidhja e tij/saj me një prind shqiptar me anë të dokumentit të identifikimit ose certifikatës së lindjes. Shtetasit e huaj që lindin fëmijë në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të shkojnë pranë zyrave të gjendjes civile në mënyrë që të kërkojnë shtetësi shqiptare për fëmijën në bazë të principit *jus soli*³⁵.

31 Zgjidhja e Problemit të Pashtetësisë për Fëmijët, Një Studim mbi Shqipërinë, TLAS/RrEP Studimi 06/15, f4, <https://www.statelessness.eu/sites/www.statelessness.eu/files/Albania.pdf>

32 <http://www.refworld.org/docid/3ae6b5c10.html>

33 Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), Analizë dhe Komente për Projekt-Ligjin mbi Shtetësinë, 21 prill 1998, <http://www.refworld.org/docid/3ae6b31dab.html>

34 Zgjidhja e Problemit të Pashtetësisë për Fëmijët, Një Studim mbi Shqipërinë, TLAS/RrEP Studimi 06/15, f4, <https://www.statelessness.eu/sites/www.statelessness.eu/files/Albania.pdf>

35 Gezim Krasniqi, Albanian Citizenship Configurations in the Balkans [Përshtatjet e Shtetësisë Shqiptare në Ballkan], Central and Eastern European Migration Review, Vol. 6, No. 1, 2017, pp. 49-64

4.2.2. Marrja e shtetësisë me anë të natyralizimit

Neni 9 i Ligjit shqiptar mbi Shtetësinë parashikon procedurat normale, të thjeshtuarat dhe të jashtëzakonshmet për natyralizimin.

Në rastet e një natyralizimi normal, një i huaj që ka plotësuar një aplikim për marrjen e shtetësisë shqiptare me anë të natyralizimit e fiton këtë nëse ai ose ajo plotëson gjashtë kushtet e mëposhtme: është mbi 18 vjeç, ka qenë banor i ligjshëm në Republikën e Shqipërisë në mënyrë të pandërprerë për të paktën 5 vjet, ka një vendbanim të siguarur dhe të ardhura të mjaftueshme; nuk ka rekorde kriminale, di pak gjuhën shqipe, dhe nuk është kërcënim për sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë³⁶.

Neni 11 shton se nëse të dy prindërit fitojnë shtetësinë shqiptare me natyralizim, fëmijët e tyre, nën 18 vjeç, mund të fitojnë shtetësinë shqiptare me kërkesë të prindërve dhe me lejen e fëmijës, nëse ky/kjo i/e fundit është mbi 14 vjeç.

Refugjatët nuk janë pjesë të kategorive që i jepen procedura të thjeshtuara për natyralizim. Ata mund të fitojnë shtetësinë shqiptare bazuar në rregullat e përgjithshme që vlejnë për të huajt në Shqipëri, me të njëjtat dokumenta të kërkuara. Kjo është një pengesë e vërtetë për refugjatët duke qenë se ata shpesh nuk mundën të marrin këto dokumenta nga vendi i tyre i origjinës.

Për më tepër, akti i natyralizimit në Shqipëri duhet ratifikuar me një dekret të Presidentit të Republikës³⁷. Personi i interesuar duhet të plotësojë dokumentat e kërkuara dhe Ministria e Brendshme i kontrollon dhe i verifikon këto të fundit përpara se t'i nisë kërkesën presidentit. Presidenti dhe Ministria e Brendshme kanë prerogativa të ndryshme, Ministria kontrollon nëse formati i kërkesës është i duhuri, ndërsa Presidenti vendos mbi bazën ligjore të aplikimit.

Procedurat e natyralizimit të thjeshtuar përdoren në rast bashkëshortësh, individësh me origjinë shqiptare apo personash pa shtetësi. Prandaj, kushtet e mëposhtme, që kërkohen në një natyralizim të rregullt, nuk janë të domosdoshme për një person pa shtetësi; të qenit mbi 18 vjeç, të pasurit banim dhe mjete financiare të mjaftueshme, mospasja e rekordeve kriminale për të cilat ligji parashikon një dënim me burg me të paktën tre vjet dhe dije bazë të gjuhës shqipe.

Sidoqoftë, njerëzit pa dokumenta dhe në rrezik pashtetësie — por jo zyrtarisht të njohur si pa shtetësi — duhet të aplikojnë për shtetësi shqiptare nëpërmjet procedurave normale. Rrjedhimisht ata nuk përfitojnë nga lehtësitë ligjore të sipërpërmendura, pasi duhet të plotësojnë të gjithë kërkesat, përfshirë të qenit banues të ligjshëm në mënyrë të vazhdueshme për të paktën 5 vite në Shqipëri dhe të pasurit banim dhe të ardhura të mjaftueshme. Këto kërkesa janë shpesh të pamundura për t'u plotësuar nga një person pa dokumenta.

³⁶ Neni 9 i Ligjit "Mbi Shtetësinë Shqiptare" parashikon që një i huaj që ka plotësuar një aplikim për marrjen e shtetësisë shqiptare me anë të natyralizimit e fiton këtë nëse ai ose ajo plotëson gjashtë kushtet e mëposhtme: (i) është mbi 18 vjeç; (ii) ka qenë banor i ligjshëm në Republikën e Shqipërisë në mënyrë të pandërprerë për të paktën 5 vjet; (iii) ka një vendbanim të siguarur dhe të ardhura të mjaftueshme; (iv) nuk ka rekorde kriminale; (v) di pak gjuhën shqipe; dhe (vi) nuk është kërcënim për sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë.

³⁷ Nenet 17-23 e Ligjit nr. 8389 "Për Shtetësinë Shqiptare" datë 05.08.1998, i amenduar nga Ligji nr. 8442 "Mbi Disa Ndryshime të Ligjit nr. 8389, i datës 5 gusht 1989" përcaktojnë procedurën.

4.2.3. Humbja e shtetësisë

Sipas ligjit, një fëmijë mund të humbasë shtetësinë e tij/saj shqiptare vetëm kur të dy prindërit bien dakort që fëmija të heqë dorë nga shtetësia. Ndonjëherë, kjo praktikë ndiqet edhe kur nje prind nuk është dakort, për sa kohë humbja (zëvendësimi me një shtetësi tjetër) e shtetësisë shqiptare konsiderohet në interesin e fëmijës. Një kërkesë për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare nuk mund të miratohet, nëse personi nuk sjell garanci për marrjen e një shtetësie tjetër. Prandaj, sot, asnjë kërkesë për heqjen dorë nga shtetësia nuk pranohet për sa kohë autoritetet përkatëse nuk janë të sigurtë që fëmija ka ose do të marrë një shtetësi tjetër. Për të provuar këtë, individit duhet të sjellë një dokument zyrtar që provon që ka një shtetësi të re ose që premtton marrjen e një shtetësie të re.

4.3. Pashtetësia në ligjin shqiptar

4.3.1. Një përcaktim i paplotë i shtetësisë

Ligji shqiptar i shtetësisë parashikon mbrojtje të veçanta për fëmijët e braktisur ose për personat që kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare me premtimin e një shtetësie tjetër, por që nuk e fitojnë atë shtetësi brenda një periudhe kohe të arsyeshme.

Neni 3.2 i Ligjit shqiptar “Për të Huajt” përcakton një person pa shtetësi si “një person që nuk ka shtetësinë e asnjë shteti.” Ky përkufizim është i paplotë krahasuar me përcaktimin e ligjit ndërkombëtar mbi personat pa shtetësi si “një individ që nuk konsiderohet shtetas i asnjë vendi nga aplikimi i ligjit të këtyre vendeve.”

Mospërfshirja e frazës “nga aplikimi i ligjit”, në ligjin shqiptar është një boshllëk i rëndësishëm në përkufizim. Kjo do të thotë që ata që duhen të kenë një shtetësi por i është mohuar si pasojë e mungesës së ekzekutimit (apo diskriminimit në ekzekutim) të ligjit nuk mund të konsiderohen të jenë pa shtetësi në vend. Në mungesën e një procedure për identifikimin dhe mbrojtjen e personave pa shtetësi, efekti i këtij boshllëku mund të mos jetë shumë i dukshëm në praktikë, por mbetet i rëndësishëm, duke qenë se mund të rezultojë në mosidentifikimin e personave pa shtetësi.

Neni 3 i Ligjit “Për të Huajt” gjithashtu parashikon mundësinë e lëshimit të dokumenteve të udhëtimit ose lejeve të banesës, për shkaqe humanitare, personave me statusin e pashtetësisë, të cilët përcaktohen nga autoritetet kompetente. Sidoqoftë, ligji shqiptar nuk ofron as një status të veçantë për njerëzit pa shtetësi, as një instrument për identifikimin e pashtetësisë dhe as një procedurë për përcaktimin e statusit. Për shkak të mungesës së një ligji mbi pashtetësinë, statusi ligjor i personave pa shtetësi nuk rregullohet nga ligji. Për më tepër, në praktikë, individët pa shtetësi nuk i ofrohen dokumenta udhëtimi për t’i lejuar të ikin nga vendi.

Hendeku në përkufizim i identifikuar më sipër, së bashku me mospasjen e një procedurë për përcaktimin e pashtetësisë i ndalon njerëzit pa shtetësi të njihen si të tillë në Shqipëri dhe të përfitojnë të drejtat dhe mbrojtjet bazë si dhe mundësinë për të marrë një dokument udhëtimi apo një leje banese sipas parimeve humanitare.

Sidoqoftë, ashtu si do të përshkruhet në kapitullin 5, shumica e personave të identifikuar nga anketimi janë “në rrezik pashtetësie” dhe i përmbushin kushtet për t’u konsideruar si shtetas shqiptar. Prandaj, ky problem shpesh qëndron te konfirmimi i shtetësisë. Për personat në rrezik pashtetësie, ashtu si për refugjatët, të njohur si të tillë po jo si pa shtetësi për mungesë të një procedurë për përcaktimin e pashtetësisë, aksesimi në të drejta si shërbimet sociale, është shpesh i limituar, dhe ndonjëherë i pamundur.

4.3.2. Parandalimi i pashtetësisë

4.3.2.1. Parandalimi i pashtetësisë në lindje

4.3.2.1.1. Dhënia e shtetësisë fëmijëve pa shtetësi të lindur në territorin shqiptar

Ashtu siç u përmend më lart, çdo fëmijë i lindur në territorin e Republikës së Shqipërisë, edhe me prindër që janë shtetas të një vendi tjetër por që janë banues të ligjshëm në Shqipëri, mund të përfitojë shtetësinë shqiptare. Sidoqoftë, ligji përjashton fëmijët me prindër që nuk janë banues të ligjshëm në Shqipëri — dhe për më tepër kërkon lejen e të dy prindërve. Fëmijët që kanë prindër të huaj apo pa shtetësi dhe që nuk janë banues të ligjshëm në Shqipëri nuk kanë mundësi për të marrë shtetësinë shqiptare, edhe sikur kjo do të thotë që ngelen pa shtetësi. Ky është një boshllëk i qartë në legjisllacionin shqiptar dhe është në kundërshti me termat e Koventës së 1961 dhe KESH, në të cilat Shqipëria është pjesë³⁸.

Për më tepër, në praktikë ka pengesa për regjistrimin e lindjeve të fëmijëve të azilkërkuesve, siç janë vonesat në lëshimin e lejeve të banimit, bashkuar me faktin që ndonjëherë azilkërkuesit preferojnë të lenë Shqipërinë pa një çertifikatë lindje të fëmijëve të tyre.

Prindërit me shtetësi jo-shqiptare që duan shtetësi shqiptare për fëmijët e tyre lindur në Shqipëri duhet të aplikojnë duke dorëzuar dokumente që provojnë që ata janë banorë të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë. Pas kësaj, fëmija regjistrohet menjëherë si shtetas shqiptar bazuar në procedurën e nisur nga prindërit e tij/saj. Institucioni përgjegjës për këtë proces është zyra e gjendjes civile në zonën ku prindërit banojnë ose në zonën ku gjendet fëmija. Këto zyra janë pjesë të Drejtorisë të Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila është pjesë e Ministrisë së Brendshme.

³⁸ Gezim Krasniqi, Albania to Grant Citizenship to Ethnic Albanians in the Neighbourhood and Diaspora [Shqipëria Ofron Shtetësi për Shqiptarët Etnikë në Kufij dhe Diasporë], Citizenship in South East Europe, 2013, <http://www.citsee.eu/blog/albania-grant-citizenship-ethnic-albanians-neighborhood-and-diaspora>

4.3.2.1.2. Dhënia e shtetësisë fëmijëve pa shtetësi lindur jashtë vendit

Neni 7 i Ligjit nr. 8389, datë 5 gusht 1998 “Për Shtetësinë Shqiptare” i amenduar nga Ligji nr. 8442, datë 21 janar 1999 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8389, datë 5 gusht 1998 “Për Shtetësinë Shqiptare” parashikon që “kushdo që lind duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare.” Ky parashikim nuk ndan midis rasteve kur prindërit janë të martuar ose jo. Fëmija fiton shtetësinë shqiptare, për sa kohë të paktën njëri nga prindërit ka shtetësi shqiptare, edhe nëse prindërit nuk janë të martuar.

Nga kjo dispozitë ligjore përfitojnë të gjithë fëmijët, të lindur brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Nëse fëmija është lindur jashtë territorit të Shqipërisë nga prindër që janë shtetas shqiptarë, që nga dhjetori 2016, regjistrimi bëhet sapo prindërit paraqiten në një institucion diplomatik të Shqipërisë në vendin ku ka lindur fëmija. Kjo bëhet duke sjellë dokumentat që provojnë se fëmija është lindur në atë vend (psh. dokumentacion nga spitali ku fëmija u lind)³⁹. Ligji për Gjendjen Civile është ndryshuar në dhjetor të 2016 dhe konsullatat shqiptare nuk kanë më fuqi për të regjistruar lindjet e fëmijëve të shtetasve shqiptarë⁴⁰.

Në mënyrë alternative, nëse fëmija lindet jashtë vendit dhe është regjistruar në një zyrë të gjendjes civile jashtë Shqipërisë, prindërit, nëse janë shtetas shqiptarë, mund të regjistrojnë fëmijën e tyre drejtpërdrejtë në zyrën vendore të gjendjes civile. Në këtë rast, çertifikata e lindjes duhet të jetë në formatin e parashikuar nga ligji, pra një akt i legalizuar që njihet dhe nga autoritetet shqiptare.

Legjislacioni shqiptar përputhet me konventat ndërkombëtare në lidhje me marrjen e shtetësisë nga fëmijët e shtetasve të vet të lindur jashtë, sepse nuk le hapësira për mbetjen pa shtetësi të këtyre të fundit. Sidoqoftë, në praktikë, kërkesat e ngurta për plotësimin e procesit të regjistrimit, siç është pasja e një akti të legalizuar regjistrimi, mund ta vendosin fëmijën në rrezik pashtetësie pasi ndalon një fëmijë të lindur jashtë, me prindër shqiptarë, t’i njihet shtetësia. Ne do të shohim më poshtë në Pjesën 6 shembullin e Greqisë, ku autoritetet nuk i lëshojnë një çertifikatë lindje atyre që jetojnë në mënyrë të parregullt në Greqi dhe ku bashkëpunimi me autoritetet konsullorë shqiptare është ndonjëherë jo efikas ose mungon fare.

39 Neni 41/3 i Ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për Gjendjen Civile,” i ndryshuar si më poshtë:

“Për fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas shqiptarë, me banim të përhershëm në Shqipëri, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në përfaqësitë diplomatike ose konsullorë shqiptare, në vendin ku ka lindur. Kur kjo është e pamundur, regjistrimi bëhet edhe në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi.”

40 Ligji nr.134/2016, datë 22.12.2016, Fletorja Zyrtare nr.265, “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për Gjendjen Civile.”

4.3.2.2. Parandalimi i pashtetësisë në kontekste të tjera

4.3.2.2.1. Fëmijët e braktisur

Neni 8(1) i Ligjit nr. 8389 i datës 5 gusht 1998 “Për Shtetësinë Shqiptare,” i ndryshuar parashikon, “Një fëmijë i lindur ose i gjetur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë merr shtetësinë shqiptare në rast se ai është lindur nga prindër të panjohur, dhe si pasojë fëmija do të mbetet në rast të kundërt pa shtetësi. Në rast se prindërit e fëmijës bëhen të njohur përpara se fëmija të ketë arritur moshën 14 vjeç, dhe ata janë me shtetësi të huaj, shtetësia shqiptare mund të hiqet më kërkesë të prindërve të njohur ligjërisht, me kusht që fëmija të mos mbetet pa shtetësi si pasojë e këtij veprimi.”

Me anë të kësaj dispozite, legjislacioni shqiptar ofron një garanci se fëmijët e braktisur, prindërit e të cilëve/cilave janë të panjohur për autoritetet, nuk do të mbeten pa shtetësi, pasi fëmija regjistrohet si shtetas shqiptar. Në terma ligjorë nuk ka pengesa për marrjen e shtetësisë nga fëmijët e lindur në Shqipëri — nuk ka limit moshe apo rrezik pashtetësie nëse prindërit zbulohen më vonë. Thënë kjo, legjislacioni është në përputhje me konventat në të cilat Shqipëria është pjesë në lidhje me mbrojtjen e të drejtës së shtetësisë të fëmijëve të gjetur.

Sipas nenit 49 të Ligjit nr. 10129, datë 11 maj 2009 “Për Gjendjen Civile” i ndryshuar:

- “1. Fëmija me prindër të panjohur prezumohet i lindur në vendin ku është gjetur dhe në kohën që përcaktohet me raport mjekësor.
2. Fëmija me prindër të panjohur pajiset me procesverbal nga organet përkatëse të rendit publik dhe raport mjekësor, të lëshuar nga mjeku i zonës ku është gjetur.
3. Me kërkesë të shërbimit të gjendjes civile ose, kryesisht, me miratimin e kryetarit të bashkisë/njësisë bashkiake/komunës, ku është gjetur fëmija, atij i caktohet emri e mbiemri, si dhe emra prindërisht imagjinarë, që mund të ndryshojnë me kërkesë të vetë fëmijës, kur bëhet madhor, ose me vërtetimin ligjërisht të prindërve.
4. Rregullat e mësipërme vlejnë edhe për fëmijët me prindër të panjohur, që kanë humbur kujtesën ose janë të paafte mendërisht dhe që nuk identifikohen. Fëmijës së gjetur mund t’i ndryshojë kjo gjendje, në rastet kur i kthehet kujtesa, kur shërohet mendërisht ose identifikohet me një mënyrë tjetër.
5. Në të gjitha rastet e parashikuara në këtë nen, fëmija i gjetur regjistrohet në vendin, ku vendoset për jetesë, me përjashtim të të gjeturit madhor, që flet vetëm gjuhë të huaj e që regjistrohet si person pa shtetësi.
6. Kriteret e përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe për personin madhor, që ka humbur kujtesën, që është i paafte mendërisht e që nuk i dihen prindërit, është gjetur me prindër të vdekur, të paidentifikuar, përveç rastiit, kur ky person flet vetëm gjuhë të huaj. Në këtë rast ai trajtohet si person pa shtetësi.”

Fëmijët e braktisur e marrin shtetësinë shqiptare me vendin e gjetjes që trajtohet si vendi tyre. Sidoqoftë, regjistrimi është kusht praktik i rëndësishëm për fitimin e shtetësisë. Ligji shqiptar, lidhur me procesin e regjistrimit të një fëmije në zyrën e gjendjes civile, kërkon dy elementë, *së pari* një dokument të vlefshëm që provon lindjen dhe *së dyti*, një person të autorizuar për të bërë deklaratën e lindjes. Regjistrimi si fëmijë i braktisur (sipas procedurës nga neni 49) kërkon bashkërendimin e tre institucioneve, njësinë bashkiake apo komunën ku është gjetur fëmija (ose ku jeton fëmija), qendrën shëndetësore të atij vendi dhe zyrën e gjendjes civile. Këto tre institucione janë të detyruara të identifikojnë raste të tilla dhe në bashkëpunim me njëra-tjetrën lehtësojnë regjistrimin e fëmijës. Specifikisht, punonjësi i rendit publik në njësinë bashkiake ose komunë ka detyrë të sjellë fëmijën dhe personat që e shoqërojnë atë në qendrën shëndetësore, e cila duhet ta pajisë fëmijën me një raport mjekësor që përcakton gjininë dhe moshën e përafërt të fëmijës dhe së bashku me punonjësin e zyrës së gjendjes civile regjistrojnë të dhënat dhe bëjnë regjistrimin e fëmijës.

Në praktikë, problemet që kanë ekzistuar në vite lidhur me regjistrimin civil në Shqipëri dhe mosregjistrimi i fëmijëve pa kujdes prindëror kanë krijuar telashe për persona të cilët për një kohë shumë të gjatë nuk kanë qenë në gjendje të regjistrohen drejtpërdrejtë në regjistrin civil. Kjo dispozitë është përdorur për të zgjidhur regjistrimin e fëmijëve dhe, rrjedhimisht, uljen e pashtetësisë për këtë kategori. Prandaj, shumë fëmijë janë regjistruar si fëmijë të gjetur dhe kanë fituar vetiu shtetësinë shqiptare. Më vonë, ndiqen procedurat gjyqësore për t'i caktuar një kujdestar ligjor fëmijës. Fatkeqësisht, nuk ka të dhëna për të përcaktuar saktësisht nga ana sasiore fjalinë e fundit⁴¹.

4.3.2.2.2. Birësimi dhe Surrogacia

Nën ligjet e vendit tonë, nëse dy shtetas shqiptarë birësojnë një fëmijë, ai/ajo fiton vetiu shtetësinë shqiptare. Një fëmijë i birësuar merr gjithashtu shtetësinë shqiptare nëse vetëm një nga prindërit birësues është shtetas shqiptar, me kusht që të dy prindërit të jenë banues në Republikën e Shqipërisë. Pas vendimit të gjykatës për miratimin e birësimit të fëmijës, ai/ajo regjistrohet në gjendjen familjare të prindërve birësues dhe rrjedhimisht fiton shtetësinë e tyre. Prandaj, nuk është e nevojshme që prindërit të ndjekin një procedurë të veçantë për fitimin e shtetësisë nga fëmija i birësuar. Nëse fëmija ka pasur një shtetësi të huaj, ai/ajo mund ta humbasë këtë të fundit në varësi të kuadrit ligjor të vendit ku i është dhënë kjo shtetësi.

Sipas Kodit të Familjes në Shqipëri, birësimi është i parevokueshëm, ndaj nëse një fëmijë fiton shtetësinë me anë të birësimit ai/ajo nuk mund ta humbasë. Një fëmijë mund të humbasë shtetësinë e tij/saj shqiptare nëse ai/ajo birësohet nga shtetas të huaj — me kusht që ai/ajo të fitojë një shtetësi të re falë procesit të birësimit. Thënë këto, nuk ka prova se birësimi mund të sjellë rrezik pashtetësie sipas ligjit shqiptar.

⁴¹ Zgjidhja e Problemit të Pashtetësisë për Fëmijët, Një Studim mbi Shqipërinë, TLAS/RrEP Studimi 06/15, f4, <https://www.statelessness.eu/sites/www.statelessness.eu/files/Albania.pdf>

Ligji shqiptar nuk merret në mënyrë të veçantë me fitimin e shtetësisë nga fëmijët që lindin nëpërmjet procesit të surrogacisë. “Surrogacia” përmendet drejtpërdrejtë nga neni 261 i Kodit të Familjes, i cili flet për birësimin surrogativ dhe i referohet ligjit shqiptar për shëndetin riprodhues. Ky ligj thotë që birësimi surrogativ do të ndjekë procedurat normale shqiptare të birësimit. Teorikisht, një fëmijë i lindur në këtë mënyrë do të birësohet nga prindërit dhe do të ketë mundësinë të fitojë shtetësinë shqiptare sipas të njëjtave rregullave të përmendura më lart. Ligji mbi shëndetin riprodhues parashikon që procedura do të rregullohet nga aktet nënligjore, por asnjë i tillë nuk është formuluar ende rreth kësaj teme. Gjithashtu, nuk ka informacion nëse raste të tilla janë ndeshur në praktikë dhe si janë zgjidhur.

4.3.2.2.3. Rifitimi i shtetësisë shqiptare

Neni 14 i ligjit shqiptar mbi shtetësinë i jep mundësinë të gjithë personave që kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare, për shkak të premtimit të një shtetësie të tjetër, të rifitojnë shtetësinë shqiptare nëse nuk e kanë marrë shtetësinë tjetër të premtuar brenda një periudhe kohe të arsyeshme. Për më tepër, neni 24 parashikon se, “personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe nuk ka shtetësi tjetër, i rijepet shtetësia menjëherë, mbi bazën e kërkesës së paraqitur prej tij.”

4.3.3. Regjistrimi i lindjes dhe atësia

Ligji i 2009 për gjendjen civile rregullon regjistrimin e lindjes në kapitullin 6 (nenet 38-45). Duhet të themi se Shqipëria nuk ka një regjistër elektronik për regjistrimin e lindjeve, prandaj prindërit duhet të plotësojnë manualisht në letër një aplikim për regjistrimin e lindjes pas ardhjes në jetë të fëmijës. Aktualisht, UNICEF po mbështet MShMS dhe njësitë nën të për të dixhitalizuar të dhënat e lindjeve në sistemin shëndetësor, por asnjë ndërhyrje nuk është planifikuar ende në regjistrimin e lindjeve të regjistri civil⁴².

Kodi i Familjes i 2003 është i lidhur me regjistrimin e lindjeve bazuar në nenin 43 (4) të Ligjit për Gjendjen Civile “Njohja dhe kundërshtimi i atësisë e i amësisë bëhen sipas kritereve të përcaktuara në Kodin e Familjes,” nenin 165 të Kodit të Familjes, “Amësia dhe atësia e fëmijës së lindur nga martesë provohen nga akti i lindjes, i regjistruar në regjistrin e gjendjes civile,” dhe kapitujt e amësisë (nenet 175-179) dhe atësisë (nenet 180-191).

Për t’i përmbledhur, nenet e mëposhtme të Kodit të Familjes konsiderohen më të rëndësishmet lidhur me boshllëqet e regjistrimit të lindjeve në Shqipëri:

- Neni 180 (1): “Fëmija që ka lindur gjatë martesës prezumohet se ka për atë bashkëshortin e nënës.”
- Neni 167: “Nga njohja e amësisë ose e atësisë së një fëmije të lindur jashtë martesë nuk mund të hiqet dorë.”

⁴² Studimi dhe Vlerësimi i Situatës për Mundësimin e Regjistrimit Elektronik të Porsalindurve në Shqipëri, TLAS-UNICEF, <http://www.tlas.org.al/sites/default/files/Executive%20Summary%20ne%20shqip.pdf>

•Nenet 176 dhe 182: “Amësia dhe atësia, për një fëmijë me prindër të panjohur, mund të njihen me testament. Kjo njohje, qoftë dhe me testament, nuk mund të revokohet.”

•Neni 181: “Atë i fëmijës së lindur jashtë martesë është personi madhor që e nje fëmijën si të tij. Njohja e atësisë është e vlefshme kur për këtë jep pëlqimin nëna e fëmijës.”

•Neni 189: “Atësia e një fëmije të lindur jashtë martesë mund të vërtetohet me vendim të gjykatës, në rast se gjatë gjykimit provohet se në kohën e zënies së fëmijës i ati bashkëjetonte me nënën e fëmijës, ose ka kryer marrëdhënie seksuale me apo pa dhunë, ose i ka premtuar martesë, ose nga një gjykim penal apo civil rezulton në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi atësia e fëmijës së lindur jashtë martesë, si dhe kur dihet publikisht se ai e ka njohur fëmijën si të tijin.”

Teorikisht, çdo fëmijë ka të drejtën e regjistrimit të lindjes pavarësisht rrethanave familjare. Sidoqoftë, situata mund të ndërlikohet kur ka grindje familjare pasi, psh., prindërit mund të mos duan të regjistrojnë lindjen e fëmijëve jashtë martesës. Pra, nëse nëna është e martuar, fëmija i saj mund të regjistrohet vetëm si fëmijë i saj dhe i bashkëshortit, edhe nëse ky i fundit nuk është i ati biologjik. Pasi fëmija është regjistruar me atësinë e bashkëshortit, nëse nëna divorcohet me të sipërpërmendurin dhe martohet me të atin biologjik të fëmijës, një rast i ri kujdestarie duhet të hapet për të rivendosur atësinë. Këto raste kudestarie shpesh kërkojnë një test ADN që kushton rreth 400 - 800 Euro. Prandaj, shumë prindër vendosin të mos e regjistrojnë lindjen e fëmijës pa zgjidhur më parë problemet familjare, që të shmangin një procedurë gjyqësore të vështirë pas divorcit.

Për më tepër, Kodi i Familjes bëhet pengesë kur divorci i prindërve shtyhet si pasojë e mosmarrëveshjeve të tjera civile (mbi pronat, kujdestarinë, shtëpinë, pensioni, etj), prandaj nënat shpesh nuk duan të regjistrojnë lindjen e fëmijëve me atësinë e bashkëshortit (që nuk është i ati biologjik).

Një mundësi për të zgjidhur këtë problem është ndarja e regjistrimit të lindjes me përcaktimin e atësisë, si vepohet në vende të tjera, psh. në Serbi. Nëse regjistrimi i lindjes mund të bëhet pa emërimin e atësisë, dhe nëse nëna mund t'i shtojë të dhënat e atësisë në një fazë të mëvonshme, procedurat gjyqësore mbi atësinë e rreme dhe korrigjimet mund të shmangen⁴³.

4.3.4. Regjistrimi i lindjes dhe pashtetësia

Regjistrimi i lindjes mund të luajë një rol kyç në sigurimin e njohjes të së drejtës të një personi për shtetësi në një vend. Në Shqipëri, regjistrimi i lindjes është i lidhur fort me fitimin e shtetësisë në lindje dhe, në fakt, shtetësia është një nga elementët kyç të identitetit të vendosur në regjistrimin e individit. Si rezultat i pengesave të ndryshme në procesin e regjistrimit të lindjes, ka disa raste ku fëmijët kanë të drejtën e marrjes së shtetësisë shqiptare (*jus sanguinis*) por nuk njihen si të tillë për shkak të mosregjistrimit.

Regjistrimi i fëmijëve në Republikën e Shqipërisë rregullohet me anë të ligjit nr. 10129, datë 11 maj 2009 “Për Gjendjen Civile” i ndryshuar. Ky ligj thotë se prindërit kanë përgjegjësinë kryesore për regjistrimin

⁴³ Ligji për Shtetësinë në Republikën e Serbisë, 2004, <http://www.refworld.org/docid/4b56d0542.html>

e fëmijës të tyre dhe në rast se kjo dështon, është detyra e institucioneve shtetërore për të vazhduar procedurën. Neni 38 (1) thotë se, *“Lindjet si fakt, kohë, vend, gjinia dhe amësia vërtetohen me certifikatën e asistencës së lindjes, me raport mjekësor ose procesverbal, të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm, si dhe përgjegjësi i trenit, kapiteni i anijes ose i avionit në udhëtim, drejtuesi i burgut ose i repartit ushtarak, organi i rendit publik, apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit, në mungesë të personelit mjekësor.”* Ligji njih të dhënat e mbajtura në një anije apo avion për të provuar faktin e lindjes. Nëse të dhënat pohojnë saktësisht lindjen, fëmija regjistrohet menjëherë në zyrën e gjendjes civile në Shqipëri, nëse anija apo avioni mban flamurin e shtetit shqiptar. Natyrshëm, të gjithë kushtet e tjera, të sipërpërmendura për fëmijët e lindur në territorin shqiptar, duhet të plotësohen për të marrë shtetësinë.

Dokumenti kyç që provon lindjen është certifikata e asistencës në lindje që i jepet çdo nëne në spitalin ku ka lindur. Dokumenti duhet të dërgohet në zyrën përkatëse të gjendjes civile (zyra ku nëna është regjistruar ose zyra më afër banimit të nënës) e cila regjistron të sapolindurit dhe mban aktin e lindjes së fëmijës. Lindja mund të provohet edhe me anë të një raporti mjekësor ose raporti të shkruar (në momentin e lindjes) kur lindja bëhet jashtë spitalit, psh. në shtëpi, tren, anije, avion ose burg. Raporti i shkruar duhet të mbahet nga përgjegjësi i mjetit të udhëtimit ose institucionit. Në raste të tjera, kur nëna nuk mund të provojë lindjen me anë të një dokumenti të shkruar, ose kur ky raport nuk është në formatin e kërkuar, ajo duhet të shkojë në gjykatë për të vërtetuar faktin e lindjes.

Lindja e një fëmije deklarohet në zyrën e gjendjes civile nga prindërit, të rritur të tjerë të familjes, kujdestarët, përfaqësuesit ligjorë dhe në mungesë të gjithë këtyre nga persona të tjerë që mund të provojnë të drejtën. Një fëmijë i lindur në Shqipëri nga prindër të huaj, të cilët nuk janë banues të ligjshëm të Republikës së Shqipërisë, nuk fiton shtetësinë shqiptare, por mundet, të paktën teorikisht të regjistrohet. Në raste të tilla, fëmija regjistrohet me shtetësinë e prindërve. Ligji nuk vendos kufizime mbi kohën e regjistrimit, por inkurajon regjistrime të hershme. Sidoqoftë, UNHCR raportoi se regjistrimi i fëmijëve me prindër pa leje banimi i është refuzuar azilkërkuësve.

Nënat që regjisrojnë të sapolindurit brenda 60 ditësh nga lindja (lindje brenda territorit të Republikës së Shqipërisë) ose brenda 90 ditësh (lindje nga shtetas shqiptarë jashtë Shqipërisë) marrin një shpërblim monetar (përafërsisht 5000 AL ose 40 Euro)⁴⁴.

Fëmijët e braktisur ose të dhënë për adoptim regjistrohen në zyrën e gjendjes civile në të njëjtën zonë ku kanë lindur. Kur janë të disponueshme, fëmija regjistrohet sipas të dhënave të të nënës (në dokumentin e saj të identifikimit). Fëmija regjistrohet si i gjetur nëse nëna nuk njihet ose nuk mund të vërtetohet identitetin e saj (i mungojnë dokumentet e identifikimit). Pas kësaj, fëmija kalon një procedurë birësimi apo vendosje kujdestarie. Deklarata e lindjes për fëmijët e gjetur bëhet nga institucionet e qeverisjes vendore ose nga institucionet përgjegjëse të rendit publik (policia) që kanë juridiksion në vendin ku është gjetur fëmija.

⁴⁴ Neni 41 i Ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për Gjendjen Civile,” i ndryshuar.

Në Shqipëri numri i lindjeve i provuar me anë të deklaratave së lindjes nga spitalet dhe maternitetet dhe numri i lindjeve regjistruar nga zyrat e gjendjes civile nuk janë të njëjtët. Numri i lindjeve të regjistruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (i cili është i njëjtë me atë të INSTAT) është më i vogël se numri i lindjeve i regjistruar nga Departamenti i Statistikave nga Ministria e Shëndetësisë që merr të dhëna nga qendrat shëndetësore dhe maternitetet. Një studim fizibiliteti për nevojën e krijimit të një regjistri elektronik për regjistrimin e lindjeve i kryer nga TLAS në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Ministrinë e Shëndetësisë, në 2013, gjeti se ndryshimet e regjistrimit të lindjeve nga Ministria e Shëndetësisë dhe zyrat e gjendjes civile në të njëjtin vit lëviznin afërsisht 10% nga njëra-tjetra. Sidoqoftë, duke konsideruar që zyrat e gjendjes civile gjithashtu regjistrojnë fëmijë të lindur jashtë institucioneve, mund të themi se diferenca është edhe më e madhe, prandaj një analizë me e thelluar është e nevojshme⁴⁵.

Ligji për Gjendjen Civile tenton të parandalojë këtë problem duke parashikuar se: “të gjitha qendrat shëndetësore, publike ose private, të autorizuar për të vërtetuar lindjet, janë të detyruara të dërgojnë çdo të hënë te zyrat e gjendjes civile, ku prindërit banojnë, informacion mbi lindjet në atë qendër. Mosrealizimi i kësaj dispozite dënohet me gjobë prej 50.000 Lekësh.” Sidoqoftë, Ministria e Shëndetësisë nuk e ka plotësuar këtë kusht (qendrat shëndetësore nuk plotësojnë raportin e sipërpërmendur) dhe Ministria e Brendshme nuk e ka aplikuar, deri më sot, këtë penalitet.

Si përfundim, kuadri ligjor shqiptar lidhur me pashtetësinë, identifikimin e rasteve të pashtetësisë është problematik pasi nuk ka një procedurë të dedikuar. UNHCR mbështet futjen e një procedure për përcaktimin e pashtetësisë, nën përgjegjësinë e një autoriteti publik. Ndërmjet boshllëqeve të tjera ligjore të identifikuara, një përcaktim i qartë për pashtetësinë mungon në Ligjin për të Huajt. Në praktikën administrative ka pengesa për dhënien e shtetësisë personave që kanë të drejtë ta kenë atë, për shkak të konflikteve familjare, regjistrimit të lindjeve të familjeve vulnerabël Rom dhe Egjiptian, regjistrimin e lindjeve të fëmijëve të lindur jashtë dhe regjistrimin e lindjeve të fëmijëve me prindër të huaj (edhe kur janë banues të ligjshëm në Shqipëri). Së fundmi, ashtu si do të përshkruhet më gjatë në kapitullin 6, tarifat dhe shpenzimet mund të jenë pengesa shtesë për njerëzit me vështirësi ekonomike.

⁴⁵ Zgjidhja e Problemit të Pashtetësisë për Fëmijët, Një Studim mbi Shqipërinë, TLAS/RrEP Studimi 06/15, f12, <http://www.tlas.org.al/sites/default/files/ENS%20-%20TLAS.pdf>

5. KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE TË PERSONAVE NË RREZIK PASHTETËSIE NË SHQIPËRI

5.1 Vështirësitë e hartëzimit të personave në rrezik pashtetësie në Shqipëri

Ashtu si thamë më lart, nuk ka të dhëna zyrtare të besueshme mbi numrin e përgjithshëm të personave në rrezik pashtetësie në Shqipëri. I vetmi informacion i disponueshëm është numri i individëve që janë vetë-deklaruar si të peregjistruar në çensusin e 2011, i cili është 7443⁴⁶.

Në vitin 2016, zyra e gjendjes civile me mbështetjen e UNHCR implementoi një *software* të ri online, i aksesueshëm nga punonjësit e gjendjes civile në nivel kombëtar dhe lokal, për përmirësimin e profilizimit të detajuar, duke regjistruar çështjet e pazgjidhura dhe mbledhjen e të dhënave demografike të individëve, si mosha, gjinia, etnia dhe vendndodhja gjeografike. Gjatë 2017, zyra e gjendjes civile, UNHCR dhe TLAS trajnuan mbi 300 punonjës të regjistrimit civil për përdorimin e këtij *software* dhe promovuan përdorimin e tij për të përmirësuar identifikimin e personave në rrezik pashtetësie.

Ky studim demografik është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, autoriteteve vendore, INSTAT, TLAS dhe UNHCR. Qëllimi i këtij studimi hartëzimi është ofrimi i një pikturë realiste e mbështetur në statistika për personat në rrezik pashtetësie në Shqipëri, si dhe informacion mbi shkaqet kryesore dhe pengesat e rëndësishme që ndesh kjo popullatë.


5.2. Një përmbledhje statistikore për popullatën e njerëzve në rrezik pashtetësie në Shqipëri

Me anë të këtij studimi hartëzimi, i cili u plotësua në katër muaj, **1031** persona në rrezik pashtetësie u identifikuan në Shqipëri. Ky grup ishte pothuaj simetrik në shpërndarjen sipas gjinisë, ku

⁴⁶ <http://www.instat.gov.al/temat/censuset/censusi-i-popullsis%C3%AB-dhe-banesave/>

48.9% e grupit ishin meshkuj dhe **51.1%** femra. Kjo e dhënë, së bashku me faktin që sipas INSTAT⁴⁷ numri i meshkujve dhe femrave në Republikën e Shqipërisë është pothuaj i njëjtë, duket se tregon që rreziku i pashtetësisë nuk përcaktohet nga gjinia e individit.

Figura 1: Individët në rrezik pashtetësie sipas gjinisë



Ashtu si pritej dhe si tregohet nga Figura 2, një shumicë dërrmuese (**96.7%**) e 1031 individëve të identifikuar si pa shtetësi ose në rrezik pashtetësie janë fëmijë.

Një ndarje më e detajuar e moshës paraqitet në Figurën 3, e cila tregon se pothuaj 50% e personave në kampionin tonë janë ndërmjet moshave 0-5 vjeç dhe më shumë se një e treta i përkasin moshave 6-14 vjeç. Së bashku, këto dy grupmosha përfshijnë 87% të gjithë personave të identifikuar në rrezik pashtetësie. Nga ana tjetër, ashtu siç tregon Figura 4, vetëm 18% e popullsisë në Shqipëri është e këtyre grupmoshave⁴⁸. Kjo tregon se fëmijët janë në mënyrë disproporcionale në rrezik për të ngelur pa shtetësi dhe se regjistrimi i lindjeve mbetet një aspekt kyç për t'u zgjidhur në kuadrin e luftës kundër pashtetësisë. Në terma sasiorë, fëmijët në Shqipëri janë 95 herë më vulnerabël ndaj çështjeve të pashtetësisë se të rriturit⁴⁹.

47 Publikimi i INSTAT "Burra dhe Gra në Shqipëri", 2017

48 INSTAT, Vjetari Statistikor 2017.

49 Ky rezultat është herësi i pjesëtimit (97/25.3) / (3/74.3). Numëruesi është herësi i pjesëtimit të përqindjes së fëmijëve në rrezik pashtetësie në kampionin tonë me përqindjen e fëmijëve në popullsinë e përgjithshme. Emëruesi përfaqëson të njëjtin veprim për të rriturit. Qasja e saktë shkencore do të kërkonte statistikë inferenciale, ndoshta një model multivariabël binary logjistik. Sidoqoftë, kjo e fundit do të ishte përtej synimit të këtij raporti dhe e papraktikueshme për shkak të madhësisë së kampionit dhe mungesës të dhënave. Në këtë rast, efekti i matur është i mjaftueshëm për analizën tonë.

Figura 2: Individët në rrezik pashtetësie sipas moshës




Figura 3: Individët në rrezik pashtetësie sipas moshës (E detajuar)






Figura 4: Shpërndarja e kampionit tonë përkundrejt popullsisë së përgjithshme sipas moshës



Një vlerësim i variablave të kombinuar të moshës dhe gjinisë tregon se në grupin e parë (0-5 vjeç) ka relativisht më pak femra se meshkuj. E kundërta është e vërtetë për grupmoshën e dytë, dmth., numri i femrave është më i madh megjithëse diferenca nuk është e madhe. Këto dy grupmosha (deri në 14 vjeç) përfshijnë respektivisht 86% të gjithë femrave dhe 89% të gjithë meshkujve. Për sa i përket pjesës tjetër të grupeve (15-18 vjeç dhe 19 vjeç ose më shumë), ata përfshijnë një pjesë më të vogël të femrave dhe meshkujve krahasuar me grupet e mëparshme, përkatësisht 14% të femrave dhe 11% të meshkujve. Si përfundim, diferencat midis gjinive, edhe kur merren parasysh ndryshimet moshore, janë shumë të kufizuara për të përcaktuar ndonjë lidhje midis gjinisë dhe rrezikut të pashtetësisë.


Figura 5: Individët në rrezik pashtetësie sipas moshës dhe gjinisë (Të kombinuara)



5.2.1 Shpërndarja gjeografike e personave në rrezik pashtetësie

Sipas të dhënave tona, pjesa më e madhe e personave në rrezik pashtetësie janë identifikuar në Tiranë (18%), Fier (12%), Shkodër (11%) and Gjirokastrë (10%). Nga ana tjetër, ka relativisht pak raste të individëve që ndeshen me këtë rrezik në qarqe të vogla si Kukësi, Dibra dhe Lezha.

Figura 6: Individët në rrezik pashtetësie sipas qarkut



Sidoqoftë numrat e mësipërm nuk tregojnë shumë mbi lidhjen ndërmjet vendbanimit dhe rrezikut të pashtetësisë. Për të vlerësuar këtë marrëdhënie, grafiku i mësipërm duhet të vendoset në një perspektivë relative. Figura 7 krahason përqindjen e njerëzve pa shtetësi (në kampionin tonë) në një qark me përqindjen e popullsisë së përgjithshme që jeton në atë qark. Me fjalë të tjera, ne vlerësojmë përhapjen relative të problemit të pashtetësisë. Grafiku i ri tregon që qarqe më të mëdha si Tirana dhe Durrësi, që kanë shumë persona në rrezik pashtetësie, në fakt janë më mirë, në terma relative me popullsitë e tyre të përgjithshme, sesa qarqe me më pak raste rreziku pashtetësie si Berati apo Vlora.

Figura 7: Përqindja e njerëzve në rrezik pashtetësie sipas qarkut kundrejt madhësisë relative të qarkut




Tabela 1 shtyn më tej diskutimin në paragrafin e sipërm. Duke pjesëtuar përqindjen e personave të identifikuar si në rrezik pashtetësie në secilin qark me madhësinë relative të popullsisë së qarkut mund të merret një numër që përfaqëson lidhjen midis banimit në një qark të caktuar dhe rrezikut të pashtetësisë, që për thjeshtësi po e emërtojmë “koeficienti i rrezikut të pashtetësië.” Si u përmend më lart, qasja e duhur shkencore për të vlerësuar këtë marrëdhënie do të ishte me anë të regresioneve multivariabël binar logjistik (dymbëdhjetë në këtë rast, një për çdo qark) ose me anë të një regresioni linear multivariabël (në varësi të tipit të variablave të pavarura). Sidoqoftë, duke pasur parasysh qëllimin e këtij raporti, tabela e mëposhtme ofron një zëvendësues të përshtatshëm për matjen e efektit.


Tabela 1: Koeficienti i rrezikut të pashtetësisë sipas qarkut

Qarku	Koeficienti i rrezikut të pashtetësisë sipas qarkut
Berat	2.04
Dibër	0.95
Durrës	0.9
Elbasan	0.82
Fier	1.15
Gjirokastrë	4.55
Korçë	0.96
Kukës	0.74
Lezhë	0.68
Shkodër	1.55
Tiranë	0.58
Vlorë	1.06

Secili numër tregon sesa herë më shumë një individ është i rrezikuar nga pashtetësia në qarkun përkatës krahasuar me mesataren⁵⁰. Pra, për sa i përket rrezikut të pashtetësisë duket se personat që jetojnë në Gjirokastrë janë në situatën më të keqe dhe ata në Tiranë në atë më të mirën.

Ka disa arsye që mund t'i shpjegojnë këto ndryshime. Së *pari*, nga eksperiencia e gjatë e TLAS/UNHCR dhe raporte të tjera⁵¹, ne dimë se komunitetet Rom dhe Egjiptian banojnë relativisht në numra të mëdhenj në qarqet e Fierit, Shkodrës, Elbasanit dhe Gjirokastrës. Këto komunitete, për arsye të ndryshme, janë ndërmjet grupeve më vulnerabël lidhur me problemin e pashtetësisë. Së *dyti*, rikthimi i shumë emigrantëve në Shqipëri vitet e fundit ka prodhuar më shumë raste rreziku pashtetësie në qytetet afër kufijve sesa në zonat qendrore, si Tirana. Rëndësia e kësaj pikë shpjegohet nga Figura 9, e cila tregon që shkaku më i përhapur pas pashtetësisë në Shqipëri është lindja jashtë kufijve. Së *treti*, ato OJQ që janë të specializuara në luftimin e pashtetësisë, duke përfshirë TLAS, janë të vendosura dhe kanë struktura të forta në Tiranë, por, përgjithësisht, kanë më pak burime në rrethe të tjera. Lidhur më këtë pikë, Figura 8 tregon se pas 2011 (koha kur u realizua çensusi i INSTAT-it), problemi i pashtetësisë është përmirësuar relativisht në qarqet e Tiranës, Durrësit ose Lezhës, por ka njohur përkeqësime të ndjeshme (po relativisht) në qarqet e Shkodrës, Fierit dhe Gjirokastrës (duke marrë si të vërtetë që kampioni ynë i mbledhur në katër muaj përfaqëson shpërndarjen e njerëzve pa shtetësi në Shqipëri.

Figura 8: Përqindja e popullsisë në rrezik pashtetësie sipas qarkut kundrejt çensurit të 2011



5.2.2 Shkaqet kryesore — mungesa e dokumentacionit civil/ regjistrimit të lindjes


Të dhënat e mbledhura tregojnë se faktori kryesor që ve dikë në rrezik pashtetësie është lindja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (**53%**), ndjekur nga lindja jashtë martese (**12%**), lindja në shtëpi

50 Nëse duam të krahasojmë sa herë më shumë një person është në rrezik pashtetësie duke jetuar në një qark krahasuar me një qark tjetër duhet të pjetësojmë koeficientët. Për shembull, një person që jeton në qarkun e Shkodrës është 2.28 (1.55/0.68) herë më në rrezik pashtetësie krahasuar me një person që banon në qarkun e Lezhës.

51 "Roma and Egyptians in Albania: A socio-demographic and economic profile based on the 2011 census. [Roma dhe Egjiptianët në Shqipëri: Një profilizim i bazuar në çensusin e 2011]," UNDP, 2015.

(10%) dhe lindja në maternitet me të dhëna të pasakta personale të nënës (9%). Së bashku, **84%** e personave të identifikuar ndeshin pengesa për marrjen e shtetësisë për shkak të procedurave të regjistrimit të lindjes. Vlen për t'u theksuar se **5%** e subjekteve janë përgjigjur se “nuk i dinë shkaqet e mosregjistrimit.”

Figura 9: Shkaqet e mungesës së miratimit të shtetësisë shqiptare për popullsinë në rrezik pashtetësie




Ata që janë përgjigjur me “Tjetër” i referohen aksesit në shërbime dhe situatës shoqërore dhe ekonomike të personave në rrezik. Këto përfshijnë divorcin dhe neglizhencën e prindërve, fëmijët e rritur nga të afërm, gjakmarrjen dhe fëmijët interseks.

5.2.3 Shpërndarja e personave në rrezik pashtetësie sipas vendlindjes

Nga 1031 personat e identifikuar, 544 janë lindur jashtë, që përfaqëson 53% të grupit të individëve të identifikuar. Nga ata persona të lindur jashtë, të dhënat tregojnë që **53%** janë lindur në Greqi, ndjekur nga **29%** në Gjermani dhe **6%** në Kosovë. Ashtu siç u shpjegua më lart, fëmijët shqiptarë që rikthehen ndeshen me sfida të ndryshme për t'u pajisur me dokumentacionin përkatës dhe për të konfirmuar shtetësinë e tyre.

Figura 10: Vendlindja e personave në rrezik pashtetësie lindur jashtë Shqipërisë



5.3 Burimet e të dhënave


Për sa i përket të dhënave zyrtare, mund t'i referohemi Institutit të Statistikave së Republikës së Shqipërisë (INSTAT). Të dhënat më të fundit janë mbledhur nga censusi i zhvilluar në 2011. Ajo përfshinte kategorinë e njerëzve të paregjistruar, 7443 persona. Me përjashtim të ndarjes gjinore, 3874 meshkuj dhe 3569 femra, nuk ka të dhëna të mëtejshme lidhur me shpërndarjen demografike të këtyre individëve. Të dhënat e fundit më të sakta janë mbledhur nga stafi i TLAS, bazuar në rastet e personave me rrezik pashtetësie që konfirmuan shtetësinë e tyre falë shërbimeve të ndihmës ligjore të TLAS në periudhën 2012-2016 (pas censusit), vlerësohet se numri i personave në rrezik pashtetësie është ulur në 4971.

Për këtë studim, ekspertët e TLAS mblodhën të dhëna nga institucionet e përmendura në seksionin e mëposhtëm dhe krijuan një databazë të veçantë, më anë të së cilës 1031 persona në rrezik pashtetësie u identifikuan. Databaza e menaxhimit të rasteve të TLAS lejon për organizimin e të dhënave duke përfshirë moshën, gjininë, pengesat për regjistrim, veprimet e ndërmarra për zgjidhjen e situatave, etj.

5.3.1. Grupet e mbuluara nga të dhënat administrative dhe jo-administrative

Bazuar në të dhënat e mbledhura, shumica e rasteve të identifikuara vijnë nga zyrat e gjendjes civile (24%), ndjekur nga Ministria e Shëndetësisë (21%), Ministria e Arsimit (18%), departamentet e shërbimeve sociale në nivel vendor (16%), OJQ (12%) dhe Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës (9%).

Figura 11: Burimet e të dhënave



5.3.1.1 Identifikimi i rasteve me anë të projektit “Sokrates”

Veçmas raportit tonë, Ministria e Arsimit, me asistencën e projektit dixhital “Sokrates” ka lajmëruar zyrën e gjendjes civile për 1130 studentë që nuk kanë prezantuar një dokument regjistrimi të shkollat përkatëse. Nga ky numër, 995 fëmijë nuk u gjendën në Regjistrin Civil. Megjithëse ky kontroll nuk do të thotë që të gjithë 995 fëmijët janë vetiu pa shtetësi, pasi mund të kenë një shtetësi tjetër dhe nuk janë të regjistruar në regjistrin shqiptar, ai mund të shërbejë si një hap parandalues kundër rrezikut të pashtetësisë.

Autorët e këtij raporti vlerësojnë që projekti “Sokrates” mund të jetë shumë i rëndësishëm në të ardhmen për parandalimin e rasteve të reja të pashtetësisë dhe për zgjidhjen e rasteve ekzistuese. Për më tepër, një vlerësim i situatës aktuale është i nevojshëm për të gjithë ministrinë përkatëse për të adresuar boshllëqet në sistem. I vetmi shqetësim që ne kemi lidhet me nevojën për një bashkëpunim më të ngushtë midis institucioneve publike dhe OJQ. Për shembull, ne kemi zbuluar se 49 nga fëmijët e identifikuar nga Ministria e Arsimit u gjetën dhe nga studimi ynë — pra e njëjta punë u bë dy herë për shkak të mungesës së koordinimit. Duke punuar së bashku mund të kursehen kohë dhe burime, të cilat mund të ndihmojnë një tjetër person vulnerabël.

6. SFIDAT E MBETURA PËR PARANDALIMIN E PASHTETËSISË DHE MBROJTJEN E PERSONAVE NË RREZIK PASHTETËSIE NË SHQIPËRI

Siç u pa më sipër, legjislacioni shqiptar për pashtetësinë nuk mundëson as një parandalim të plotë të pashtetësisë, as një mbrojtje të mjaftueshme të njerëzve që janë ose mund të jenë në rrezik pashtetësie.

6.1. Parandalimi i pashtetësisë

Mangësitë e legjislacionit shqiptar, sfidat gjatë regjistrimit të lindjeve dhe sfidat e tjera burokratike, si dhe mungesa e mbështetjes shtetërore për regjistrimin pasues, ulin mundësitë për parandalimin e pashtetësisë.

6.1.1. Mangësitë e legjislacionit shqiptar

6.1.1.1. Mungesa e procedurave të përcaktimit të pashtetësisë

Gábor Gyulai përkufizon procedurën e përcaktimit të statusit pa shtetësi si “një procedurë të formalizuar bazuar në dispozita specifike ligjore dhe që ka për qëllim të përcaktojë nëse një person është pa shtetësi (*de jure* ose *de facto*). Një procedurë e tillë mund të kryhet ose me kërkesë të një të huaji (ngjashëm me procedurën e përcaktimit të statusit të refugjatit), ose ex officio (për shembull në rastin e të huajve të paligjshëm, në përgatitjen e dëbimit të tyre)⁵².”

Siç u pa më sipër në këtë raport, neni 3 (2) i Ligjit shqiptar “Për të Huajt” përcakton përkufizimin e një personi pa shtetësi — “person pa shtetësi nënkupton një person që nuk është shtetas i ndonjë shteti”

⁵² Gábor Gyulai, Raporti i Komunitetit Hungarez të Helsinkit, “Forgotten Without Reason - Protection of Non-Refugee Stateless Persons in Central Europe [Harruar pa Arsye - Mbrojtja e Personave pa Shtetësi Jo-Refugjatë në Europën Qendrore],” 2007

— i cili megjithatë bie nën standardet ndërkombëtare. Për më tepër, nuk ka procedura specifike dhe formale për të përcaktuar pashtetësinë. Megjithatë, identifikimi i personave pa shtetësi dhe dhënia e të drejtave themelore u lejon atyre të marrin pjesë plotësisht dhe të kontribuojnë në shoqërinë në të cilën jetojnë. Ai gjithashtu ul kostot dhe rreziqet e sigurisë që lidhen me marginalizimin e personave pa shtetësi⁵³.

Për të siguruar drejtësi dhe efikasitet, UNHCR rekomandon që procedurat e përcaktimit të pashtetësisë të sigurojnë garanci, duke përfshirë të drejtën për një zgjidhje efektive në rast të kërkesës së refuzuar. Ndiurma juridike duhet të jetë e disponueshme dhe taksat administrative për aplikimet për pashtetësi duhet të ulen. Së fundmi, deportimi i individëve që kanë një kërkesë në pritje në një procedurë për përcaktimin e pashtetësisë duhet të pezullohet deri në vendimin përfundimtar të autoriteteve⁵⁴.

Për më tepër, një person pa shtetësi mund të mos përfitojë akoma nga natyralizimi i lehtësuar për shkak të kësaj mungese të procedurës së përcaktimit të pashtetësisë. Në të vërtetë, fakti që mungon procedura për përcaktimin e pashtetësisë, pengon zbatimin e dispozitave ligjore. Kështu, megjithëse ligji shqiptar siguron fëmijët e personave pa shtetësi me të drejtën për të fituar shtetësinë e vendit ku ata kanë lindur, ata mund të privohen nga kjo e drejtë, sepse prindërit e tyre nuk kanë mundësinë të dëshmojnë statusin e tyre si persona pa shtetësi.

Në këtë pikë, Shqipëria mund të marrë shembull nga legjislacioni fqinj i Kosovës⁵⁵ i ndryshuar në vitin 2013 dhe aktet nënligjore të miratuara në vitin 2015, dhe veçanërisht nga udhëzimi administrativ për procedurën dhe kriteret e përcaktimit të pashtetësisë.

6.1.1.2. Mungesa e procedurave jo të kontestueshme për të rregulluar regjistrimin e parakohshëm të lindjes

Në Shqipëri, pengesat për regjistrimin e lindjes së fëmijës përfshijnë: një mungesë fleksibiliteti të zyrtarëve publikë, bashkëpunim dhe njohuri të kufizuara të nëpunësve të zyrës së gjendjes civile, autonomi të kufizuar të nëpunësve civilë për zgjidhjen e rasteve, mungesë informacioni dhe trajnimi të personelit të regjistrimit civil, lindjen në shtëpi apo mungesën e bashkëpunimit nga autoritetet lokale dhe administrata qendrore.

Për të ndrequr çështjet e regjistrimit të lindjeve të parakohshme, disa vende fqinje përmirësuan legjislacionin e tyre, veçanërisht duke paraqitur procedurat për përcaktimin e datës dhe vendit të lindjes për personat.

53 Raporti i UNHCR, "Statelessness determination procedures - Identifying and protecting stateless persons [Procedurat e përcaktimit të pashtetësisë - Identifikimi dhe mbrojtja e personave pa shtetësi],", gusht 2014, f3, www.refworld.org/docid/5412a7be4.html

54 Konkluzionet e mbledhjes së ekspertëve UNHCR "Statelessness Determination Procedures and the Status of Stateless Persons [Procedurat e përcaktimit të pashtetësisë dhe statusi i personave pa shtetësi],", dhjetor 2010, f4, www.refworld.org/docid/4d9022762.html

55 <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20Citizenship%20of%20Kosovo.pdf>

Kështu, Serbia në vitin 2012 miratoi ndryshimet në ligjin për procedurën e jo kontestueshme, me kusht që personat të cilët nuk janë të regjistruar në librat e regjistrimit të lindjes dhe si rezultat janë në rrezik pashtetësie, të paraqesin një kërkesë në gjykatë për të përcaktuar datën dhe vendin e lindjes⁵⁶. Edhe në qoftë se kjo procedurë është e papërsosur, kryesisht për shkak të procesit të ngadaltë që shtrihet nga vendimi i gjykatës që përcakton datën dhe vendin e lindjes së një personi në regjistrimin e tyre në librat e amzës dhe lëshimin e certifikatës së lindjes, ende ka meritën e ekzistencës, dhe me kalimin e kohës po bëhet gjithnjë e më efikase⁵⁷.

Në Kosovë, Ligji i ri për Gjendjen Civile gjithashtu lejon përdorimin e dëshmitarëve në regjistrimin e lindjeve për të gjithë banorët që nuk kanë dokumentet e kërkuara⁵⁸. Ligji në veçanti parashikon të drejtën e të gjithë fëmijëve të lindur brenda Kosovës për t'u regjistruar në librat e amzës, pa marrë parasysh vendbanimin e përhershëm të prindërve të tyre⁵⁹.

Megjithatë, nuk mund të mos thuhet se edhe kur një vend adopton legjislacionin e duhur për të shmanhur shfaqjen e pashtetësisë, ky legjislacion nuk ka efekt nëse nuk zbatohet në mënyrën e duhur.

6.1.2. Regjistrimi i lindjeve dhe sfidat burokratike

Për periudhën 2005-2012, UNICEF në Shqipëri vlerësoi se regjistrimi i lindjeve është 98.6 përqind. Regjistrimi i lindjeve mbetet problematik për fëmijët e lindur:

- Jashtë institucioneve të kujdesit shëndetësor.
- Jashtë vendit (dy sisteme të ndryshme administrative / ligjore).
- Nga prindër të cilët japin të dhëna të gabuara, braktisin fëmijët e tyre, nuk regjistrojnë fëmijët e tyre, ose një kombinim i të gjithave⁶⁰.

6.1.2.1. Në Shqipëri

Ekzistojnë dallime midis kornizave ligjore teorike dhe funksionimit aktual të institucioneve. Procedurat administrative të gjata, komplekse dhe të kushtueshme vazhdojnë të jenë një pengesë e madhe për shumë persona që rrezikojnë të jenë pa shtetësi. Pakicat e marginalizuara, veçanërisht Romët, shpesh hasin vështirësi në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për konfirmimin ose marrjen e shtetësisë.

56 Stephanie Woldenberg, "Access to Civil Documentation and Registration in South Eastern Europe: Progress and Remaining Challenges since the 2011 Zagreb Declaration [Aksesi në Dokumentacionin Civil dhe Regjistrimin në Europën Juglindore: Progresi dhe Sfidat e Ngelura nga Deklarata e Zagrebit 2011]," Raporti për Komisionerin e Lartë të OSBE për Minoritetet Kombëtare, UNHCR dhe KE, 2013 <http://www.refworld.org/pdfid/5280c5ab4.pdf>

57 Raporti PRAXIS "Analysis of Practical Application of the Law on Non-Contentious Procedure Determining the Date and Place of Birth [Analiza e Aplikimit Praktik të Ligjit në Procedurën Jo-Kontestimore Përcaktimi i datës dhe vendit të lindjes]," 2013, f5-15

58 Ligji Kosovar për Gjendjen Civile Nr. 04/L-003, 23 qershor 2011, <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20civil%20status.pdf>

59 UNICEF, Every Child Counts: Birth registration in Kosovo [Çdo fëmijë ka vlerë: Regjistrimi i lindjes në Kosovë], https://www.unicef.org/kosovo-programme/UNICEF_Birth_Registration_2009_English.pdf

60 UNICEF, Child Notice Albania 2015 [Njoftimi i Fëmijëve për Shqipërinë], 2015, f29, <https://www.unicef.nl/files/unicef-child-notice-albania.pdf>

Me rëndësi, brenda Planit Kombëtar për Integrimin e Komuniteteve Roma dhe Egjiptian në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020, ekziston një kapitull dedikuar regjistrimit civil dhe aksesit në drejtësi⁶¹.

Këto pengesa mund të jenë reale ose të perceptuara. Për shembull, frika për t'u ngarkuar me një tarifë spitalore për lindjen pa sigurim shëndetësor është nxitje për disa gra që të lindin në shtëpi. Ose disa gra pa dokumente mund të marrin hua broshurën shëndetësore të një të afërmi për të shmangur taksat, dhe foshnja rrjedhimisht është e regjistruar ligjërisht me një familje tjetër. Për më tepër, spitalet ndonjëherë nuk arrijnë të zbatojnë detyrimin e tyre ligjor për të raportuar lindjet në zyrën e gjendjes civile⁶².

Nëse një familje zgjedh për një regjistrim të mëvonshëm, kërkesat janë të shumta dhe përfshijnë dhënien e kartave të identitetit të të dy prindërve, vendbanimin e regjistruar ligjërisht të prindërve, certifikatat e martesës, tarifat e lidhura me procesin administrativ. Të gjitha këto kërkesa mund të jenë veçanërisht problematike për Romët, të cilët mund të mos kenë dokumentet e identifikimit, jetojnë në vendbanime të paligjshme, mund të mos jenë zyrtarisht, por tradicionalisht të martuar dhe të kenë të ardhura të ulëta.

Sidoqoftë, praktikat administrative ndryshojnë nga një vend në tjetrin, varësisht nga vullneti, si dhe nga kapacitetet dhe njohuritë e organeve administrative lokale dhe zyrtarëve komunalë. Problemi është se dështimet ose shkeljet administrative shpesh ndikojnë në popullatat vulnerabël dhe të diskriminuara që nuk mund të njohin të drejtat e tyre ose kanë akses të kufizuar në drejtësi dhe mundësi të kufizuara për të apeluar kundër vendimeve administrative.

Ashtu si përshkruan UNHCR në Planin e Veprimit Global për Eliminimin e Pashtetësisë 2014-2024, reformat e ligjeve dhe politikave të shtetësisë, edhe nëse ato shkojnë drejt përmirësimit, ndonjëherë janë të vështira për t'u arritur në praktikë. Përveç kësaj, pikëpamjet shoqërore mbizotëruese në lidhje me pakicat etnike, fetare ose të tjera mund të jenë të vështira për t'u ndryshuar. Ndonjëherë, qeverive thjesht u mungojnë kapacitetet për të ndërmarrë luftë kundër pashtetësisë⁶³.

6.1.2.2. Jashtë vendit

Kompleksiteti dhe sfidat që lidhen me regjistrimin e lindjeve janë përkeqësuar në rastet e fëmijëve të lindur jashtë vendit, veçanërisht kur prindërit jetojnë jashtë vendit në mënyrë të paligjshme. Si pasojë, fëmijët nuk kanë të regjistruar lindjen e tyre ose vetëm marrin një njoftim të lindjes që nuk përfshin informacionin bazë të kërkuar nga autoritetet shqiptare për të vazhduar me regjistrimin e lindjes së tyre.

61 The National Plan for Integration of Roma and Egyptian Communities in the Republic of Albania 2016-2020 [Plani Kombëtar për Integrimin e Komuniteteve Roma dhe Egjiptiane në Republikën e Shqipërisë 2016-2020], f 25-27, <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/national-action-plan-for-integration-of-roma-and-egyptians-in-th.html>

62 UNHCR, "Report on Statelessness in South Eastern Europe [Raport mbi Pashtetësinë në Europën Juglindore]", Zyrtar e UNHCR në Bosnje, Maqedoni, Serbi, Kosovë, Kroaci dhe Mal të Zi, shtator 2011, f28

63 UNHCR Global Action Plan to End Statelessness 2014-2024 [Plani Global i Veprimit i UNHCR-së për t'i dhënë fund pashtetësisë 2014-2024], nëntor 2014, f8, www.unhcr.org/54621bf49.html

Deri në dhjetor 2016, neni 41 (3) i ligjit të Gjendjes Civile të vitit 2009 parashikonte që regjistrimi i lindjes së fëmijëve të lindur jashtë Shqipërisë bëhet në misionin diplomatik ose konsullor të vendit ku ai ka lindur. Për më tepër shtonte se, “kur kjo është e pamundur, regjistrimi bëhet në shërbimin civil të atij vendi.” Ligji ndryshoi në dhjetor të vitit 2016 dhe misioni diplomatik apo konsullor shqiptar nuk ka më kompetencë të regjistrojë lindjen e fëmijëve të shtetasve shqiptarë⁶⁴.

Pra, për të regjistruar lindjen e fëmijës të lindur jashtë vendit, duhet të merret certifikata e lindjes së fëmijës nga vendi i lindjes dhe duhet të jetë në formën e parashikuar nga ligji: një akt i ligjshëm, i përkthyer në shqip dhe i noterizuar. Ky dokument duhet të verifikohet nga Ministria e Jashtme dhe Ministria e Brendshme e vendit të huaj. Pastaj duhet të legalizohet në Konsullatën Shqiptare të vendit të huaj. Ky dokument duhet të përkthehet dhe përkthimi të noterizohet. Pas këtij procesi, fëmija mund të regjistrohet në zyrën e gjendjes civile në Shqipëri⁶⁵.

Kërkesat burokratike të kësaj procedure janë të vështira dhe të shtrenjta dhe shpesh të pamundura për t'u përmbushur, veçanërisht për emigrantët pa dokumente që lindin në vende të huaja. Për shkak të mungesës së tyre të dokumentacionit dhe statusit të parregullt, shpesh ata shmangin lindjen në spitale dhe prandaj nuk marrin gjithmonë certifikata lindjeje. Në rastin më të mirë, ata marrin një njoftim lindje, i cili nuk ka të gjithë informacionin që kërkojnë autoritetet shqiptare. Shumë prindër nuk arrijnë të trajtojnë të gjitha pengesat burokratike të lidhura me legalizimin e çertifikatave të lindjes në vendin e huaj dhe të kthehen në Shqipëri para se të marrin një çertifikatë në formën e kërkuar nga autoritetet shqiptare. Në raste të tilla, këto çertifikata nuk legalizohen dhe lindjet e fëmijëve nuk janë të regjistruara në Shqipëri pavarësisht nëse prindërit janë shqiptarë. Kjo pengon regjistrimin e lindjes së fëmijëve dhe, për shkak se shumë shpesh nuk janë në gjendje të kthehen në vendin ku kanë lindur fëmijët për të zgjidhur çështjen, ekziston një rrezik më i madh se këta fëmijë do të ngelen pa shtetësi.

Ky problem është veçanërisht i rëndësishëm për fëmijët e lindur në Greqi ku autoritetet refuzojnë të lëshojnë një çertifikatë të plotë të lindjes për ata që jetojnë në mënyrë të parregullt në vend dhe për ta verifikuar atë për qëllime ligjore me autoritetet shqiptare, që refuzojnë të pranojnë akte të thjeshta të huaja për regjistrimin civil.

6.1.3. Regjistrimi pasues

Si u tha më lart, shumë raste të rrezikut të pashtetësisë, qoftë të identifikuar apo jo, janë për shkak të një mungese të thjeshtë të regjistrimit të lindjes dhe rrjedhimisht mungesës së dokumentave të identifikimit. Më vonë, regjistrimi kërkon ndihmë ligjore dhe administrative që shumica e njerëzve në fjalë nuk dinë se ku mund t'i përfitojnë dhe/ose nuk mund t'i përballojnë.

⁶⁴ Ligji Nr. 134/2016, Datë.22.12.2016, Fletorja zyrtare Nr.265 “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime të Ligjit Nr. 10 129, Datë 11.5.2009, “Për Gjendjen Civile,” i ndryshuar.”

⁶⁵ <http://www.punetejashtme.gov.al/en/legalization-of-documents&page=1>

Regjistrimi pasues është një procedurë e ndërlikuar dhe e kushtueshme në Shqipëri, duke përfshirë kryesisht një test ADN (acid deoksiribonukleik) të nënës dhe dokumentacionin e identitetit të prindërve. Megjithëse Shqipëria miratoi një Ligj për Ndhmën Juridike Falas⁶⁶ dhe aktet nënligjore përkatëse në vitin 2011 dhe 2012, që teorikisht garantonin shërbime falas për ndihmë juridike primare dhe sekondare për personat të cilët nuk mund t'i përballojnë ato, akesi në drejtësi mbetet një sfidë e vërtetë për një popullatë të pambrojtur. Ndër mangësitë e këtij Ligji mbi Ndhmën Juridike Falas si mungesa e buxhetit, përzgjedhja e kufizuar e përfituesve, mungesa e avokatëve të përgatitur për të marrë rastet e Ndhmës Juridike dhe shpenzimet e larta të tarifave gjyqësore vazhdojnë të përjashtojnë njerëzit vulnerabël dhe janë denoncuar nga aktorë të ndryshëm. Kostot e testeve të ADN për të vërtetuar identitetin e fëmijës dhe lidhjet prindërore ende duhet të plotësohen nga kërkuesi/prindi, megjithëse laboratorët shtetërorë mund ta ofrojnë këtë shërbim pa pagesë në rastet e regjistrimit të lindjes.

Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë ka tarifa për personat që duhet të marrin dokumentet e identifikimit të lëshuara nga jashtë të çertifikuara nga konsullata ose ambasada. Këto pengesa tregojnë mungesën e marrjes së përgjegjësisë mbi këtë problem nga Ministria dhe rrezikun për zgjerimin e pashtetësisë në të ardhmen. Më keq akoma, në rastin e romëve dhe egjiptianëve, ka një tendencë për të zhvendosur të gjitha përgjegjësitë tek Ministria e Mirëqenies Sociale dhe e Rinisë, ndërkohë që institucionet e tjera të interesuara shpesh nuk e shohin punën pro-aktive si pjesë të aktiviteteve të tyre kryesore⁶⁷.

6.2. Mbrojtjet në dispozicion për personat pa shtetësi dhe personat në rrezik të pashtetësisë

6.2.1. Pengesat për akses në drejtësi dhe ndihmë juridike

Siç u përmend më lart, Shqipëria miratoi një ligj mbi ndihmën juridike në vitin 2008 dhe aktet nënligjore të mëvonshme të hartuara për të garantuar shërbime falas për ndihmë juridike për ata që përndryshe nuk do të ishin në gjendje të përballonin shpenzimet që lidhen me një proces ligjor. Megjithatë, fondet që janë vënë në dispozicion nuk plotësojnë kërkesat, kriteret e përzgjedhjes për kualifikimin e ndihmës juridike janë tepër kufizuese, avokatët nuk janë në dispozicion për të marrë rastet e ndihmës juridike dhe tarifat gjyqësore mbeten të larta. Kjo do të thotë se vetë njerëzit që sistemi është projektuar për të ndihmuar, të cënueshmit dhe të varfërit, vazhdojnë të përjashtohen dhe shpesh as nuk e dinë se kanë të drejtë për ndihmë juridike.

Kjo është e vërtetë edhe në lidhje me mungesën e dëmshtëpërblimit ligjor dhe aksesin në drejtësi për ata që iu është refuzuar dhënia e dokumentacionit ose që nuk kanë qenë në gjendje të marrin dokumenta

⁶⁶ Ligji për Ndhmën Juridike Falas, Ligji nr. 10039, 22 dhjetor 2008, www.eurallius.eu/pdf/13.Law%20on%20Legal%20Aid,%20promulgated%20on%2012_01_2009_en.pdf

⁶⁷ Milena Isakovic Suni, Comparing Approaches to Combating Statelessness in Albania and Serbia [Krahasimi i qasjeve për luftimin e pashtetësisë në Shqipëri dhe Serbi], qershor 2015, f6, <https://www.statelessness.eu/sites/www.statelessness.eu/files/2015-05-14%20Comparing%20Approaches%20Albania%20and%20Serbia.pdf>

për shkak të çështjeve strukturore të identifikuar më sipër. Ndhma ligjore luan një rol vendimtar në këtë kontekst. Jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vendet e tjera të Europës Juglindore, OJQ-ve iu është dashur të plotësonin boshllëqet dhe kanë luajtur një rol kyç në përparimin e të drejtave të personave në rrezik të pashtetësisë, si dhe duke advokuar për përmirësimet në legjislacion.

Sipas Ligjit për Ndhmën Juridike, Ministria e Drejtësisë zhvillon politikën shtetërore në fushën e shërbimeve të ndihmës juridike për individët. Ajo gjithashtu duhet të ndihmojë në përgatitjen e akteve të nevojshme ligjore, të sigurojë zbatimin e dispozitave ligjore dhe të vlerësojë cilësinë e ndihmës ligjore të ofruar. Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike punon nën Ministrinë e Drejtësisë dhe zbaton politikën e qeverisë për ofrimin e ndihmës juridike për individët, menaxhimin e buxhetit publik të përcaktuar për ndihmë juridike, vendosjen e kriterëve për vlerësimin e cilësisë së shërbimit dhe bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile që punojnë në këtë fushë.

Pavarësisht këtyre mekanizmave, ndihma juridike falas mbetet kryesisht e paarrtshme për njerëzit pa shtetësi ose pa dokumente, sepse ata nuk mund të sigurojnë gjithmonë dokumentacionin e nevojshëm, veçanërisht dëshmitë e banimit ose ndihmën ekonomike/të ardhura, për të verifikuar të drejtën e tyre për të marrë ndihmë juridike.

Për më tepër, sistemi nuk ofron në praktikë asistencë ligjore për personat në rrezik pashtetësie. Sipas ligjit, ndihma juridike mund të sigurohet për çështjet e regjistrimit civil, por vetëm për ata që mund të provojnë se nuk mund t'i paguajnë shpenzimet dhe që përfitojnë nga ndihma ekonomike. Duke qenë se individët në rrezik pashtetësie nuk kanë të drejtë për ndihmë ekonomike, ata nuk mund të përfitojnë nga sistemi i ndihmës juridike. Si rezultat, deri më tani, ndihma juridike për regjistrimin civil dhe rastet e shtetësisë ka qenë dhe vazhdon të sigurohet nga organizatat jofitimprurëse.

Së fundmi, Komisioni Shtetëror i Ndhmës Juridike nuk ka kapacitete dhe burime për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave. Edhe numri i vogël i personave që marrin ndihmë juridike përballat me rrezikun real të mospërfaqësimit efektiv. Në fakt, avokatët e ndihmës juridike kanë mungesë kapacitetesh dhe paguhen pak⁶⁸.

Duhet të theksohet që në kohën e shkrimit të këtij raporti, ka një reformë në zhvillim e sipër të Ligjit për Ndhmë Juridike. Ligji i ri u miratua nga Parlamenti në dhjetor 2017, dhe do të hyjë në fuqi më 1 qershor 2018⁶⁹. Ndër ndryshimet e tjera legjislative, ai shfuqizon Komisionin Shtetëror për Ndhmë Juridike.

Personat pa shtetësi që banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të përkohshme ose të përhershme dhe janë pajisur me leje qëndrimi në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt, mund të përfitojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti. Po kështu, personat pa shtetësi që hyjnë rregullisht në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe përfitojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare të

68 Komentete Euralius për të Ardhmen e Ndhmës Juridike në Shqipëri, <http://www.euralius.eu/index.php/en/neës/211-abolishment-of-state-commission-for-legal-aid>

69 Ligji nr. 111/2017 "Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti," <https://www.parlament.al/ep-content/uploads/2017/12/ligj-nr.-111-dt.-14.12.2017.pdf>

ratifikuara nga Republika e Shqipërisë ose në bazë të parimit të reciprocitetit, gjithashtu mund të përfitojnë nga ndihma juridike e garantuar nga shteti⁷⁰. Mundësia për të përfituar ndihmë juridike dytësore (përfaqësimi nga avokati) jepet me vendim gjykatë. Në anën tjetër, ndihma ligjore parësore (këshillimi dhe mbështetja ligjore) do të sigurohet nga punonjësit e trajnuar posaçërisht, organizatat jofitimprurëse ose klinikat ligjore në institucionet e arsimit të lartë⁷¹.

6.2.2. Faktori i diskriminimit

Ndjenjat anti-rome gjithashtu mund të rrisin rrezikun e pashtetësisë, kur punonjësit e regjistrimit civil refuzojnë të regjistrojnë ose të lëshojnë dokumente për individët romë me pretekstin se nuk paguajnë taksat e tyre. Kjo praktikë, natyrisht, është e ndaluar nga një udhëzim i veçantë i Ministrisë së Brendshme⁷².

Në vitin 2013, Avokati i Popullit propozoi ndryshimin e Ligjit për Gjendjen Civile, duke rritur ndërgjegjësimin për faktin se shumë romë dhe egjiptianë jetojnë në vendbanime informale dhe nuk mund të gëzojnë të drejta politike, sociale apo ekonomike si qytetarë për faktin se nuk janë regjistruar zyrtarisht si banues në administratat lokale dhe komunale⁷³.

Anëtarët e shoqërisë civile shqiptare dhe të intervistuarit sugjeruan se një nga pengesat kryesore të regjistrimit civil për romët është mungesa e dijenisë për dokumentacionin e duhur, kulturën e migrimit të vazhdueshëm, ndjeshmërinë sociale dhe ekonomike dhe diskriminimin e përhapur në jetën e përditshme duke përfshirë edhe trajtimin dekurajues në zyrat civile. Përveç kësaj, duke pasur parasysh nivelin e lartë të korrupsionit në Shqipëri, romët vulnerabël mund të kenë hasur më shumë vështirësi në kalimin e procedurave të regjistrimit të lindjes.

Për më tepër, diskriminimi kundër romëve në Shqipëri i nxit ata të emigrojnë, gjë që e bën edhe më të komplikuar për ta fitimin e shtetësisë. Diskriminimi ndikon në vendimet mbi emigracionin, të cilat më pas rrezikojnë marrjen e shtetësisë ose natyralizimit, e cila shpesh bazohet në kriteret e qëndrimit. E gjithë kjo krijon një rreth vicioz.

